



KOLEGJI UNIVERSITAR “BEDËR”

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Mësuesi në Gjuhë Angleze” me Profile
“Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe
“Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

1. Edona Llukaçaj Ph.D. (kryetare)
2. Msc. Albana Çekrezi (anëtare)
3. Msc. Indrit Lami (anëtar)
4. Msc. Elsuida Hoxhaj (anëtare)
5. Melinda Bushaj (përfaqësuese e studentëve)

Shkurt/ 2023

PËRMBAJTJA

LETËR SHOQËRUESE	3
PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM	4
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM	5
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	6
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË	10
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT	20
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT	32
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE	41
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT	50
PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”	58
SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT	63

LETËR SHOQËRUESE¹

¹ Evidenca nr. 1: Mendimi i Dekanit

Adresa: "Rruga e Durrësit"


Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Kolegji Universitar “Bedër”(KU “Bedër”) u liçencua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 6.04.2011 (i ndryshuar)², për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. KU “Bedër” është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional është marrë në vitin 2013 nga APAAL,³ riakredituar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017⁴. Gjatë vitit akademik 2020 - 2021 institucioni përfundoi me sukses riakreditimin institucional dhe me vendim të Bordit të Akreditimit, nr.57, datë 16.12.2021 u akreditua deri në vitin 2026⁵. Akreditimi i të gjitha programeve të studimit që ofrohen, është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe standardeve të KU “Bedër”.

Në këtë kuadër u çel dhe Programi Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë Angleze” me Profile ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë’ dhe ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët’⁶, pjesë e Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, për të cilin po aplikohet për akreditim pranë agjencisë suaj, pas riorganizimit të tij, zgjat 2 (dy) vite akademike, të ndarë në 4 (katër) semestra. Programi përbëhet nga 120 ECTS, ku për çdo vit parashikohen 60 ECTS, të ndara në 30 ECTS për çdo semestër. Programi i studimit është projektuar t’ju ofrojë formim profesional dhe intelektual në përputhje me strategjitë, dhe nevojat kombëtare të tregut të punës në këtë fushë specifike, duke përfshirë në kurrikulën e vet një shumëllojshmëri konceptesh dhe pikëpamjesh me qëllim përgatitjen e mësuesve të gjuhës Angleze të aftë për tu integruar dhe kontribuar në sistemin parauniversitar të edukimit dhe për të implementuar metodat klasike dhe bashkëkohore të mësimdhënies.

Mësimdhënia e gjuhës angleze kërkon gërshetimin e kujdesshëm të njohurive të mbështetura në hulumtime me aspektin praktik të tyre dhe aftësinë për ta përcjellë përmes metodave të përshtatshme, çfarë bën të domosdoshme përgatitjen e studentëve në të gjithë këto aspekte. Programi Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë Angleze me Profile ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë’ dhe ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët’” pranë KU Bedër ofron mësimin e metodave dhe teknikave kryesore të mësimdhënies, përgatitjen e kurrikulave dhe programeve të përshtatshme mësimore, mësimdhënien e integruar dhe atë të aftësive të ndryshme gjuhësore në përputhje me standardet bashkëkohore.

² Evidenca nr 15: Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për liçencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)

³ Evidenca nr 93: Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2013

⁴ Evidenca nr. 37: Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2017

⁵ Evidenca nr. 45: Vendimi i Bordit të Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Për akreditimin periodik të IAL KU “B”

⁶ Evidenca nr. 22: Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me Profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*


Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ku-beder.edu.al


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të Kolegjit Universitar “Bedër”, me propozim të Këshillit të Departamentit, nën kujdesin e përgjegjës të departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze dhe me vendim të Senatit Akademik të KU “Bedër”, u vendos të ngrihet Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë Angleze me Profile ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë’ dhe ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët’”.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së, ngritur për misionin e vlerësimit të brendshëm, janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes së anëtarëve të grupit. Ky GVB ka në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë, duke përfshirë edhe përfaqësues të studentëve.

Procesi akreditimit për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë Angleze me Profile ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë’ dhe ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët’” zhvillohet për herë të parë pas riorganizimit të programit.

Drafti paraprak i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësinë bazë, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar, i cili arriti në gjetjet dhe përfundimet e paraqitura më poshtë.

Etapat e Procedurës së Vlerësimit të Brendshëm Ndjekur për Programin e Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë Angleze me Profile ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë’ dhe ‘Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët’”.

- Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.
- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftohet zyrtarisht Koordinatorin i IAL, për fillimin e procesit të akreditimit, dhe caktohet data e takimit me të për diskutimin e hapave të procesit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
- Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional në “Mësuesi Gjuhë Angleze” me profile: Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



(Handwritten signatures and initials)

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” (KU “Bedër”) si një institucion me një mision të qartë në përgatitjen e profesionistëve nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat e prioritetet kombëtare të vendit.^{7 8} Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me këto interesa në asnjë element të tij. Ky program ka si synim përgatitjen e mësuesve të gjuhës angleze për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU “Bedër” dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.⁹ Kjo është përcaktuar në misionin e këtij departamenti në lidhje me programin “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me dy profile, ku shprehet qartë se misioni i këtij programi është të përgatisë mësues të gjuhës angleze të një niveli të lartë. Studentët ndjekin lëndë për pedagogjinë, zhvillimin njerëzor, metodologjinë angleze, gjithashtu praktikën shkollore dhe pajisen me mjete të nevojshme për të vlerësuar studimet e shumta shkencore për t’i përdorur ato në dobi të praktikës mësimore.¹⁰</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është është riorganizuar dhe hapur rishtazi në 2021¹¹. Hartimi i tij është bërë në përputhje me objektivat e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Bedër” të përcaktuara qartë në planin strategjik 2018-2023 dhe në planin e parë strategjik të institucionit.¹² Në këtë plan thuhet shprehimisht se Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që të ndihen të aftë brenda mundësive që ofron tregu i punës. Kolegji Universitar “Bedër”¹³ ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, drejtësisë¹⁴ dhe teknologjisë dhe biznesit, duke sjellë një profil të qartë në</p>

⁷ Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

⁸ Evidenca nr. 8: Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023

⁹ Evidenca nr. 5: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 52

¹⁰ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

¹¹ Evidenca nr. 22: Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

¹² Evidenca nr. 8: Plani Strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023

¹³ Evidenca nr. 9: Organigrama e KU Bedër

¹⁴ Evidenca nr. 10: Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafà», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al







	tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar. ¹⁵ Kjo arrihet edhe përmes organizimit të qartë administrativ. ¹⁶			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit në fjalë është hartuar në përputhje me objektivat e zhvillimit të KU "Bedër" të përcaktuara qartë në Planin Strategjik Institucional 2018-2023 ku shprehet qartë se Kolegji Universitar "Bedër" ka si qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që të ndihen të aftë brenda mundësive të cilat i ofron tregu i punës. KU "Bedër" ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, drejtësisë dhe teknologjisë e biznesit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Misioni, vizioni dhe përbërja e personelit akademik të angazhuar në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë si dhe në Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi bazë që ofron programin e studimit "Master profesional" në Mësuesi Gjuhë Angleze me Profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> demonstrojnë se kanë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Personeli akademik i departamentit është i përbërë nga pedagogë me kohë të plotë, të cilët kanë formim të mirëfilltë akademik në fushën e mësimdhënies, pedagogjisë dhe kurrikulave. Eksperiencia e personelit me kohë të plotë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përvojat profesionale në institucione të ndryshme arsimore japin garancinë për kapacitetet e duhura në realizimin e këtij programi studimi. ¹⁷
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit "Master Profesional" në Mësuesi Gjuhë Angleze me Profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi bazë, i cili është pjesë e "Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë" si njësi kryesore e KU "Bedër". Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit dhe njësisë bazë, sipas klasifikimit të shprehur në kodifikimin të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamenti ofron gjithashtu edhe programet <i>Bachelor</i> dhe <i>Master Shkencor</i> në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Oferta akademike e plotëson

¹⁵ Evidenca nr. 5: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"

¹⁶ Evidenca nr. 11: Rregullore mbi Organizimin Administrativ

¹⁷ Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.asca.al


	kuadrin e formimit në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze si dhe mësimdhënies të Gjuhës Angleze. ^{18 19}			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit në fjalë përputhet me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, e cila është përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, si dhe në fushën e mësuesisë së Gjuhës Angleze. Kjo është e parashikuar edhe në misionin e departamentit, ku theksohet se ndër synimet e departamentit është përgatitja e mësuesve të gjuhës angleze të një niveli të lartë nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e mësuesisë dhe gjuhës angleze në tërësi.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi “Master Profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me Profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ofrohet në përputhje me profilin dhe eksperiencën e Kolegjit Universitar “Bedër”.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	KU “Bedër” duke u bazuar në nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm dhe me trajnime profesionale. Në bashkëpunim me institucionet partnere, KU Bedër, dhe posaçërisht Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, ofron trajnime profesionale ku fton vazhdimisht studentë të diplomuar të marrin pjesë. Vlen të përmenden trajnimet me <i>Educators without Borders</i> , ku krahas studentëve dhe stafit të departamentit, pjesëmarrës ishin shumë ish-studentë. Konkretisht, në periudhën 2021-2022, janë zhvilluar 4 trajnime me këto tematika: “NCFE Level 3”, “Award in Education and Training”, “Promoting Positivity in Workplace”, “Early Childhood Education” ²⁰ Një tjetër rast trajnimi për t’u përmendur është bashkëpunimi me Universitetin e North Dakota, ku Prof. Dr. Woei Hung vizitoi KU “Bedër” duke ofruar trajnime për studentët, stafin dhe të diplomuarit. ^{21 22}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

¹⁸ Evidenca nr. 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

¹⁹ Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master Profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me Profile *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*
²⁰ Evidenca nr. 90: Webminare nga “*Educators without Borders*”

²¹ Evidenca nr. 91: Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin e North Dakota


²² Evidenca nr. 92: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Woei Hung, bashkë me linqet përkatëse

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.ascal.al



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, i përmbahet qasjes së KU “Bedër” dhe ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitë akademike dhe administrative për të siguruar mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, realizohet ndarja e detyrave dhe koordinimi mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë në këshillimin akademik, realizimin e koordinimit me njësitë dhe zyrat administrative dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare.^{23 24} Në këtë mënyrë Këshilli i Departamentit përcakton këshilltarët akademikë për çdo grup studentësh, përfaqësuesin e departamentit në zyrën e këshillimit të karrierës dhe zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare.²⁵ Analiza kryhet përmes raportit vjetor të departamentit.²⁶</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave të programeve studimore, Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Më konkretisht, në këtë drejtim janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete në disa vende të Evropës, si Rumani, Kroaci, etj., që mundësojnë përfshirjen e studentëve në programe shkëmbimi.²⁷ Gjithashtu, vlen të përmenden marrëveshja e bashkëpunimit me <i>Educators without Borders</i>²⁸.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” për realizimin e praktikave profesionale për programeve të studimit, nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore apo kompani të ndryshme të fushës.²⁹ Koncretisht, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze për realizimin e programit “Master profesional” ka nënshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme të arsimit parauniversitar për realizimin e praktikave profesionale, ku vlen të përmendet marrëveshja me Kolegjin Turgut Ozal apo me disa nga Medresetë në vendin tonë³⁰, të cilët u mundësojnë studentëve gërshetimin e njohurive teorike me anën praktike. Për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve, ashtu siç u përmend edhe më sipër, institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi dhe në këtë kuadër kas pasur raste mobiliteti të stafit.³¹</p>

²³ Evidenca nr. 46: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë

²⁴ Evidenca nr. 3: Rregullore mbi Organizimin Akademik, neni I

²⁵ Evidenca nr. 47: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera

²⁶ Evidenca nr. 36: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022

²⁷ Evidenca nr. 84: Lista me Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) dhe Mobiliteti për Staf dhe Studentë me Institucionet Homologe, brenda dhe/ose jashtë Vendit

²⁸ Evidenca nr. 87: Marrëveshja e Bashkëpunimit me *Educators without Borders*

²⁹ Evidenca nr. 83: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fushën e Arsimit të Ndryshme

³⁰ Evidenca nr. 89: Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institucione Jopublike të Arsimit Parauniversitar

³¹ Evidenca nr. 97: Rast Shkëmbimi i Stafit Akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



[Handwritten signatures]

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi përgjegjëse për programin “Master profesional”, vlerëson në mënyrë periodike marrëveshjet e lidhura nga institucioni me kompani dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë se ky program studimi është në vitin e tij të parë, njësia nuk ka ende një vlerësim konkret për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatorë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Veprimtaritë formuese dhe elementët që përbëjnë programin e studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> janë të mbështetura dhe të përcaktuara në legjislacionin shqiptar mbi arsimin e lartë, studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo ndarje është në përputhje me: Ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ³² , Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë; si dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ³³
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon	Nëpërmjet lëndëve që përmban, programi i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze. Në përfundim të programit profesional, studentët e diplomuar përftojnë: - njohuri mbi konceptet dhe teoritë themelore të fushës profesionale; - njohuritë mbi pedagogjinë dhe zhvillimin njerëzor;

³² Ligji nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

³³ Udhëzimi nr. 15 dt. 04.04.2008 Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa». Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Four handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page.

<p>njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - aftësitë profesionale për t'u njohur me mjetet e duhura dhe për të vlerësuar kërkimet mbi praktikën në klasë; - aftësitë mbi metodologjinë dhe teknikat e mësimdhënies së gjuhës angleze; - aspektin praktik të lëndëve nëpërmjet praktikave profesionale dhe eksperiencës reale; - aftësinë për punë individuale dhe në grup dhe zgjidhjen e problemeve komplekse.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ka të përcaktuar qartë në rregulloren e tij ngarkesën në kredite sa i takon realizimit të praktikës profesionale dhe tezës përfundimtare, me përkatësisht 12 ECTS dhe 18 ECTS.³⁴</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> organizohet si program i ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushës përkatëse të formimit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> shtrihet në dy vite akademike, katër semestra. Programi përmban gjithsej 120 ECTS, ku 25 për qind e tyre janë në funksion të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. ³⁵Studenti realizon gjatë një viti jo më pak se 1500 orë pune. Kurrikula e programeve Master në Mësuesi është në përputhje me përmbajtjen e ofruar nga programe master që ofrojnë drejtim të njëjtë.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ka hartuar rregulloren specifike për këtë program studimi. Në rregullore janë zbatuar kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Mënyra e organizimit të programit, objektivat formuese dhe profesionale procedurat e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, plani mësimor dhe programi lëndor, kreditet e ndërtuara sipas sistemit ECTS etj janë të përcaktuara qartë në rregulloren e programit.³⁶ Të gjithë këta elementë si dhe financimi në KU “Bedër”</p>

³⁴ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

³⁵ Shih tabelen 9

³⁶ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al






	realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit.			
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Përmbajtja dhe veprimtaritë formuese të programit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ka përputhje në masën 70 për qind me përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programeve të tjera të së njëjtës fushë.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit ka ndjekur procedurat e nevojshme lidhur me kodifikimin e programit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” ³⁷ Programi përmban kodin e mëposhtëm: 72 MP 0114 A			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit, “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, programet e të cilit janë të akredituara ose në proces akreditimi. Njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin kriteret në lidhje me strukturën akademike ³⁸ , stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin brenda afateve kohore. ³⁹

³⁷ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”

³⁸ Evidenca nr. 10: Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

³⁹ Evidenca nr. 52: Vendim për Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)


Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al






<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Personeli i Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, përbëhet nga personeli akademik⁴⁰, ndihmës akademik⁴¹ dhe personeli administrativ. Në përputhje me legjislacionin departamenti angazhon stafin e nevojshëm për realizimin e praktikave mësimore dhe udhëheqjes së tezës përmbyllëse.</p> <p>Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit. Të drejtat dhe detyrat e tyre si dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës me të gjithë elementet përbërës për çdo kategori personeli të Fakultetit të Shkencave Humane është parashikuar në Rregulloren Themelore të Kolegjit Universitar "Bedër", si dhe në rregullore të tjera përkatëse⁴².</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi bazë me vendim departamenti cakton një person nga stafi akademik i cili kryen funksionin e koordinatorit për çdo programi studimi⁴³.</p> <p>Koordinatori i programit është përgjegjës lidhur me zhvillimin dhe ecurinë e programit në tërësi, si dhe për praktikat profesionale dhe detyrimet e tjera të nevojshme në përputhje me objektivat e tij.⁴⁴</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit "Master profesional" në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>.</p> <p>Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendet plani strategjik institucional, statuti i Kolegjit Universitar "Bedër", rregullorja themelore e Kolegji Universitar "Bedër", rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, rregullorja e departamentit dhe vetë programit të studimit e deri tek rregullorja e sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe</p>

⁴⁰ Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit

⁴¹ Evidenca nr. 69: CV e Stafit Ndihmës Akademik

⁴² Evidenca nr. 17: Rregullorja e Disiplinës së Personelit Akademik dhe Administrativ

⁴³ Evidenca nr. 48: Vendimi për Caktimin e Koordinatorit të Programeve Master, Viti Akademik 2022-23

⁴⁴ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, neni 9

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: asc@asc.al



(Handwritten signatures and initials)

nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët përmban planin mësimor si dhe informacionin e nevojshëm lidhur me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe orët e nevojshme. Gjatë këtij programi zhvillohen gjithsej 17 lëndë të ndara në vite akademike e semestra, ku përfshihen dhe punimi i tezës e praktika profesionale. Programi përmban gjithsej 120 ECTS. Studenti realizon gjatë një viti jo më pak se 1500 orë pune. ⁴⁵			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e programit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë ⁴⁶ , rregullorja e transferimit të studimeve ⁴⁷ paraqesin të gjitha informacionet e nevojshme të përcaktuara në mënyrë të qartë për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për leksionet, praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset për secilën lëndë janë të plota dhe përfshijnë të gjithë elementet e nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> • Pedagogu i lëndës • Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; • Përcaktimin e lëndës si të detyrueshme ose me zgjedhje • Konceptet themelore që do të trajtohen gjatë semestrit; • Orët në auditor dhe si punë individuale; • Temat e programit mësimor të lëndës specifike; • Formën e kontrollit të dijeve; • Literaturën bazë, literaturën ndihmëse; • Kreditet e mundshme, etj. • Kërkesat/udhëzimet për respektimin e kodit të etikës⁴⁸. 			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , është i sapo riorganizuar dhe nuk ka lindur nevoja që të përditësohet. Përditësimet do të ndërmerren në bazë të nevojës dhe në përputhje me politikën për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit të KU “Bedër”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

⁴⁵ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

⁴⁶ Evidenca 04: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

⁴⁷ Evidenca nr. 25: Rregullorja e Transferimit të Studimeve

⁴⁸ Evidenca nr. 19: Syllabus-et e Lëndëve të Programit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al







Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat me të mira të universiteteve publike dhe private brenda dhe jashtë vendit. Plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 4 semestra me nga 30 kredite ECTS secili. Emërtimi, përmbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike si dhe praktikat e ndryshme brenda dhe jashtë-kurrikulare u mundëson studentëve njohuri teorike dhe praktike për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët e kolegjit në tregun e punës.</p> <p>Ekziston një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktikave. Një pjesë e konsiderueshme e programit mësimor (kurrikular dhe ekstrakurrikular) i dedikohet aftësimit praktik nëpërmjet praktikave profesionale në punë konkrete në profesion, si dhe nëpërmjet projekteve dhe detyrave të kursit me karakter tërësisht praktik.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Siç u përmend dhe më sipër, plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 4 semestra me nga 30 kredite ECTS. Tabela e Planit mësimor për Programin e studimit Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> pasqyron ndarjen e ngarkesës së veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, në komponentët mësimorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; b) studim individual, si studim dhe punim relacionesh, detyrash apo projektesh; c) përgatitje për provime; d) përgatitje e tezës; e) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo internship-e pranë shkollave publike ose jopublike. <p>Në këtë plan mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet edhe përgatitjes praktike profesionale të studentëve, nëpërmjet aplikimit të praktikave profesionale, detyrave dhe projekteve me karakter praktik, pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare që kanë për qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit, vëzhgimit dhe aplikimit në praktikë të koncepteve dhe teorive të mësuara në auditor me qëllim përvetësimin më të mirë të tyre nga ana e studentëve si zhvillimin e aftësive praktike profesionale. (edu.eng.beder.edu.al)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al







<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori - praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>⁴⁹</p> <p>Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe te ngjashme ndërkombëtare.⁵⁰</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është i ndarë sipas veprimtarive formuese të cilat ruajnë edhe raportin teori-praktikë. Kjo ndarje është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t’i mundësuar studentit procesin e nxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij lëndën praktike profesionale.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri të çdo viti akademik pedagogu i lëndës është i detyruar të ngarkojë në sistemin informatik Bedër Information System (BIS) programin e lëndës që jep bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse, gjithashtu programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinorit të departamentit.</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze në fillim të çdo viti akademik realizon workshop për përditësimin e syllabus-eve me anëtarë të këshillit të departamentit, të cilët janë edhe lektorë në ciklin e parë dhe te dytë të studimeve. Gjatë këtij workshop-i bëhet analiza e disa prej syllabus-eve të lëndëve dhe diskutohen midis lektorëve mënyrat e ndryshme të përdorura prej tyre për përditësimin e syllabus-eve të lëndëve çdo vit akademik duke shkëmbyer edhe eksperiencat mbi metodat më efektive dhe eficiente duke theksuar domosdoshmërinë e rifreskimit të materialeve të përdorura si literaturë e detyrueshme dhe referencë për te përdorur materialet më të fundit të eksperiencës lokale dhe ndërkombëtare, të cilat u shërbejnë studentëve për të kuptuar situatën dhe problematikat aktuale dhe u përshtatet me kohën dhe dinamikën e komunikimit dhe teknologjinë sot. Gjithashtu trajtohet domosdoshmëria e përdorimit të terminologjive dhe tematikave të kuptueshme për studentët, duke i dhënë përparësi marrjes së njohurive bazë në fillim për te vijuar më tej me brendësinë e lëndës.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të programit të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira pozitive të disa prej universiteteve më me eksperiencë. Kjo së bashku me vijimësinë</p>

⁴⁹ Evidenca nr. 19: Syllabus-et e Lëndëve të Programit

⁵⁰ Evidenca nr. 24: Studim Tregu i Zhvilluar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze







	midis natyrës së lëndëve i ndihmon studentët që të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike, çka garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave profesionale dhe praktikimit të njohurive të marra edhe në auditor.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e këtij programi studimi u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Programet e ciklit të dytë të ofruara nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze janë një përgjigje e kërkesave të tregut të punës. ⁵¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Politikat zhvillimore të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ka zhvilluar një studim të detajuar tregu para çeljes së programit të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> . Studimi në fjalë përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimin të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe, etj. Studimi u zhvillua nga një grup pune i ngritur brenda personelit të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze si dhe me përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, si njësi përgjegjëse për programin e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> qëndron në komunikim të vazhdueshëm me partnerët dhe tregun e punës, me qëllim evidentimin dhe integrimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Në mbledhjet e Këshillit të Departamentit marrin pjesë përfaqësues të studentëve. Studentët përcjellin mendimin dhe vlerësimin e grupit mbi programin dhe lëndët specifike. Propozimet diskutohen dhe reflektohen.

⁵¹ Evidenca nr. 24 Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze




përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të diplomuarit bëhen pjesë e procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit me anë të anketës “Vlerësimi i të diplomuarve për cilësinë e programit të studimit”. ⁵²			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për të realizuar përmirësimin e përmbajtjes së këtij programi studimit departamenti, si njësia përgjegjëse e programit përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh si dhe institucione publike e private në fushën e mësuesisë. Një praktikë e konsoliduar e departamentit është përditësimi i syllabus-eve në fillim të çdo viti akademik. politika e përmirësimit të programeve të studimit parashikon përfshirjen e bashkëpunëtorëve të ndryshëm në këtë proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të tij, të cilat janë të shprehura në rregulloren e programit. ⁵³ Këto objektiva dhe prioritetet janë në përputhje të plotë me objektivat strategjikë të institucionit, të përcaktuara në planin strategjik të tij. ⁵⁴
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Përcaktuar në Statutin e KU “Bedër”, por dhe në rregulloret e tjera, roli i njësive kryesore dhe asaj bazë është që të nxisë, bashkërendojë dhe administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Në këtë aspekt, njësia bazë kërkon që nga ana e stafit akademik të ketë një pjesëmarrje sa më të madhe të tyre në veprimtari akademike dhe shkencore, duke iu dhënë edhe mbështetje financiare. ⁵⁵
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nëpërmjet aktiviteteve shkencore, si konferenca, leksione të hapura, shkolla verore etj. studentët nxiten dhe motivohen për t’u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe trajnimeve të vazhdueshme të ndryshme u mundëson studentëve të angazhohen dhe të marrin pjesë aktive në kërkimin shkencor. ⁵⁶ (https://edueng.beder.edu.al/sh/news/activities_list/)
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	Departamenti çdo vit përcakton dhe u dërgon njësive përkatëse të institucionit projekt buxhetin e tij, ku përfshin si pikë kryesore dhe mbështetjen financiare për realizimin e aktiviteteve të saj. ⁵⁷ Nga ana tjetër

⁵² Evidenca nr. 55: Listë Prezencë e Këshillit të Departamentit me Pjesëmarrjen e Studenteve

⁵³ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët

⁵⁴ Evidenca nr. 8: Plani Strategjik Institucional i KU “Bedër”. 2018-2023

⁵⁵ Evidenca nr. 34: Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor

⁵⁶ Evidenca nr. 36: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Viti Akademik 2021-2022

⁵⁷ Evidenca nr. 77: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa». Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@... .al







financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	institucioni në rregulloret e tij përcakton qartë dhe mbështetjen që i bëhet stafit akademik për çdo botim dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare. ^{58 59}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni në strategjinë e tij ka si pikë thelbësore kërkimin shkencor dhe inovacionin, duke theksuar haptazi dhe mbështetjen qoftë financiare, por edhe njerëzore për realizimin e tyre ⁶⁰ . Në këtë kontekst, realizimi i konferencës së radhës ICESS, trajnimet e ndryshme, leksionet e hapura të zhvilluara me profesionistë të fushës janë disa prej aktiviteteve të realizuara në bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit për kërkimin shkencor.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Për realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të njësisë kryesore, njësia përgjegjëse është angazhuar për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe ka angazhuar personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre aktiviteteve. Gjithashtu, anëtarë të njësisë bazë angazhohen në borde dhe komisione, ku bëhen analiza të kërkimeve shkencore. http://bjes.beder.edu.al/ . https://bjh.beder.edu.al/
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti si njësi baze e cila ofron këtë program studimi realizon periodikisht konferencën shkencore ndërkombëtare (ICESS). Njësia kryesore realizon konferenca në fusha përkatëse dhe publikimin periodik të revistës (BJH), të cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të tyre në fushën e kërkimit shkencor. ⁶¹ https://bjh.beder.edu.al/
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Ky programi studimi ofron një kurrikulë të mirë studiuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit	Departamenti u referohet rekomandimeve dhe udhëzimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së mësuesit, sipas akteve ligjore të fushës. Gjithashtu, njësia bazë realizon bashkëpunime me rrjetet profesionale të ndryshëm si dhe nxit studentët në marrjen e

⁵⁸ Evidenca nr. 12: Rregullorja për Punësimin, Promovimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit

⁵⁹ Evidenca nr. 72: Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU "Bedër"

⁶⁰ Evidenca nr. 41: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore Shkencore

⁶¹ Evidenca nr. 36: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022






përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	certifikimeve ndërkombëtare të fushës, ku vlen të theksohet bashkëpunimi me British Council. ⁶²			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi është në përputhje të plotë me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat	Format kryesore të mësimdhënies, mësim nxënies të parashikuara në rregulloren e institucionit përfshijnë leksione, seminare, orë të hapura, praktika mësimore e profesionale, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, detyra kursi dhe projekte. Përveç kësaj, Kolegji

⁶² Evidenca nr. 84: Lista me Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) dhe Mobiliteti për Staf dhe Studentë me Institucione Homologe, brenda dhe/ ose jashtë Vendlindjes

Adresa: "Rruga e Durrësit"


Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al







<p>profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Universitar “Bedër”, me anë të auditorëve me tabela inteligjente -smart board- dhe projektorëve që disponon, lehtëson transmetimin e njohurive.</p> <p>Në kuadër të programeve të studimeve, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze i KU “Bedër” organizon vizita, leksione të hapura, konferenca, workshope që të mbështesë procesin e mësimdhënies. Shembuj të aktiviteteve të ndryshme, të vizitave, shëtitjeve, orëve të hapura gjenden në raportet vjetore të departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze⁶³, në llogaritë në rrjetet sociale të departamentit, në ato të institucionit, grupeve studentore, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik respekton dhe u jep përgjigje larmisë dhe nevojave të studentëve. Studentët në KU “Bedër” përcjellin nevojat dhe kërkesat e tyre pranë personelit akademik në disa mënyra duke gjetur hapësira për mundësi alternative në mësimnxënie.</p> <p>Së pari, përditësimi i përvitshëm i silabuseve, nisur nga nevojat e ndryshme dhe diversiteti i studentëve është pasqyrim i kombinimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Procesi i vlerësimit e anketimit të silabuseve nga ana e studentëve në përfundim të çdo semestri, analizimi i gjetjeve janë një mënyrë orientimi dhe përditësimi mbi nevojat e studentëve.</p> <p>Përfaqësues të studentëve janë pjesë e mbledhjeve periodike të Këshillit të Departamentit duke përcjellë zërin, propozimet, ankesat, sugjerimet e studentëve në shqyrtim të Këshillit të Departamentit⁶⁴.</p> <p>Në përgjigje të nevojave të studentëve realizohen orë shtesë dhe konsulta me pedagogët përkatës. Komunikimi i vazhdueshëm mes studentëve dhe stafit akademik shtrihet dhe në komunikimin elektronik, hedhjen e materialeve dhe vleresimeve në google classroom, shpërndarjen në drive, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxëniet.</p>	<p>KU “Bedër” organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies⁶⁵ si dhe në fusha të tjera të nevojshme për rritjen profesionale⁶⁶. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Për më tepër, institucioni i kushton rëndësi përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme⁶⁷ si dhe realizon trajnime për personelin akademik në funksion të përmirësimit të metodave didaktike e për t’ua përshtatur objektivave formues, nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës⁶⁸. Trajnimet janë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e stafit⁶⁹.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” synon të tërheqë një staf të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë dhe në përputhje me synimet dhe standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të Institucionit. Në përmbushje të nevojave për një staf akademik me tituj shkencorë e grada shkencore,</p>

⁶³ Evidenca nr. 36: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022

⁶⁴ Evidenca nr. 39: Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit dhe në Këshillat e Fakulteteve

⁶⁵ Evidenca nr. 21: Plani i Trajnimeve të Personelit

⁶⁶ Evidenca nr. 66: Lista e Trajnimeve të Organizuara për Stafin gjatë viteve 2020-2022

⁶⁷ Shtojca 1: Mjediset dhe Infrastruktura e KU “Bedër” në foto

⁶⁸ Evidenca nr. 92: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Woei Hung, bashkë me linqet përkatëse

⁶⁹ Evidenca nr. 71: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al






<p>ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” ndjek politika të punësimit të profesionistëve vendas dhe të huaj me eksperiencë në fushën akademike, të arsimuar brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga CV-të e stafit vërtetohet se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të plotësuar objektivat e programit.⁷⁰ Në personelin akademik ka lektorë me formim në fushën e edukimit, metodikës, zhvillimit të kurrikulave, vlerësimit, gjuhësisë e letërsisë e kulturës, si dhe metodave kërkimore. Një element i rëndësishëm në këtë drejtim është shpërndarja e lëndëve të programit tek stafi akademik duke u bazuar në fushat përkatëse të ekspertizës.⁷¹</p> <p>Mësimdhënia interaktive dhe diskutimet me në qendër studentin janë pjesë e procesit të mësimdhënies në KU “Bedër”, ku studentët kanë mundësi të shprehin idetë me anë të prezantimeve, projekteve, detyrave të ndryshme. Procesi i vlerësimit gjithashtu u jep mundësi studentëve të shprehin njohuritë, aftësitë dhe kompetencat përtej provimeve klasike, edhe nëpërmjet prezantimeve, detyrave të kursit, eseve, artikujve të ndryshëm etj., gjë që mundëson shprehjen dhe zhvillimin e mendimit kritik e krijues të studentëve.⁷²</p> <p>Gjithashtu, këshilltarët akademik së bashku me pedagogë organizojnë aktivitete akademike dhe sociale me studentët bazuar në planin e aktiviteteve dhe reflektuar në planin vjetor të departamentit në kuadër të mbështetjes së ndërtimit të një marrëdhënie sa më të shëndoshë mes pedagogëve dhe studentëve.⁷³</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më lart, institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Instrumenti që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri. Pyetësori aktivizohet në sistem para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem.</p> <p>Studentët plotësojnë pyetësorët ku pyeten mbi (i) përpikërinë e pedagogëve; (ii) përgatitjen e lëndës; (iii) zotërimin e njohurive të lëndës; (iv) materialin e lëndës; (v) ndërveprimi me studentët; (vi) metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së studentëve, menaxhimi i kohës. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe siguron ruajtjen e anonimatit të studentëve gjatë realizimit të anketimeve^{74 75}.</p> <p>Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të KU “Bedër” si një kontribut për përmirësime të mëtejshme.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>

⁷⁰ Evidenca nr. 16 CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit

⁷¹ Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore

⁷² Evidenca nr. 19: Syllabus-et e lëndëve të programit

⁷³ Evidenca nr. 64: Plani i Aktiviteteve të Departamentit. 2022-2023

⁷⁴ Evidenca nr. 31: Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik

⁷⁵ Evidenca nr. 71: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa». Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asca.al

E-mail: info@asca.al



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni, gjithashtu, ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i harmonizuar mes NJSBC, departamentit dhe burimeve njerëzore, ku në bazë të propozimeve dhe sugjerimeve të ardhura koordinohet puna për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie duke përgatitur planin e trajnimeve të stafit. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimit të bërë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë. ^{76 77 78 79 80 81} (http://qac.beder.edu.al/) NJSBC në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion ka organizuar trajnime në shërbim të stafit. (https://csdi.beder.edu.al/). Gjithashtu, marrëveshja e bashkëpunimit me <i>Educators without Borders</i> ka mundësuar realizimin e një sërë trajnimesh për një pjesë të stafit akademik. ⁸²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit janë të përcaktuara në rregullore dhe dokumentacionin përkatës. Kolegji Universitar “Bedër” i pajis studentët me Guidën e Studentit ⁸³ , e cila informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU “Bedër”. Të tilla informacione bëhen të ditura edhe nëpërmjet marrëveshjes që studenti lidh me institucionin. ⁸⁴

⁷⁶ Evidenca nr. 28: Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e NJSBC

⁷⁷ Evidenca nr. 29: Shkresa nga NJSBC te HR

⁷⁸ Evidenca nr. 30: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve

⁷⁹ Evidenca nr. 33: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët

⁸⁰ Evidenca nr. 31: Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik

⁸¹ Evidenca nr. 62: Anketa Vlerësuese e Stafit Akademik ndaj Institucionit

⁸² Evidenca nr. 87: Marrëveshja e Bashkëpunimit me *Educators without Borders*

⁸³ Evidenca nr. 43: Guida e Studentit

⁸⁴ Evidenca nr. 56: Model Kontrate me Studentin






	Rregullorja Themelore e KU “Bedër” ⁸⁵ , Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë ⁸⁶ , Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ⁸⁷ , si dhe Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë ⁸⁸ parashikojnë qartësisht mënyrën e vlerësimit dhe përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga pedagogët në lëndët e ndryshme.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabus-in përkatës të çdo lënde pedagogu përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe detyrimet që duhen përmbushur nga studentët gjatë semestrit së bashku me mënyrën e vlerësimit për këto detyrime ⁸⁹ . Këto u komunikohen studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu dhe janë gjithashtu të publikuara në sistemin BIS në hapësirën e dedikuar lëndës përkatëse, në të cilën kanë akses studentët dhe pedagogu i lëndës. Syllabus-et e lëndëve për të gjitha semestrat kur është dhënë kjo lëndë janë gjithashtu të publikuara në faqen web të institucionit, në hapësirën dedikuar programit përkatës. edueng.beder.edu.al			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për t’u dhënë mundësi studentëve të shprehin dhe paraqesin njohuritë dhe aftësitë e përfutuara. Këto forma përfshijnë: testime gjysmëfinale, projekte semestrale, detyra kursi, kuice, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në leksione, provime finale etj. Këto forma u japin mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë e përfutuara, por edhe njohjen me forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njohurive dhe aftësiwe, zhvillimin e aftësiwe të punës në grup, të komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të aftësiwe prezantuese, analizuese, vlerësuese, si dhe aftësinë për të dhënë rekomandime për përmirësimin e situatave të caktuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁸⁵ Evidenca nr. 5: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 51

⁸⁶ Evidenca nr. 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

⁸⁷ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

⁸⁸ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

⁸⁹ Evidenca nr. 19: Syllabus-et e Lëndëve të Programit

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al







Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i të nxënit të studentëve të programit është i vazhdueshëm, dhe realizohet përgjatë semestrit për secilën lëndë. Gjatë një semestri janë përcaktuar dy periudha kohore për provimet; provimet e ndërmjetme -gjysmëfinale dhe provimet përfundimtare - finale. Ndërmjet tyre, studentët mund të vlerësohen me kuize, teste, projekte, detyra, pjesëmarrje në mësim, punë kërkimore, prezantime, etj. Në përgjithësi, duke ndjekur syllabus-in përkatës, vlerësimi realizohet mbi bazën e provimeve semestrale, pjesëmarrjes aktive në mësim, detyrave e prezantimeve të kursit dhe projekteve. Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për secilën lëndë në syllabusin e saj. Sipas rregullores së KU “Bedër”, për çdo lëndë, duhet të zhvillohet të paktën një provim gjysmëfinale dhe një përfundimtar.⁹⁰</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>KU “Bedër” disponon sistemin e brendshëm BIS ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse (https://bis.beder.edu.al/). Gjithashtu mund të aplikohen teste me forma elektronike, të cilat rrisin transparencën dhe eliminojnë forma të ndryshme abuzimi. Platforma google classroom jep një sërë opsionesh për vlerësimin automatik bazuar dhe në kriteret e caktuara nga pedagogu. Vlerësimi në këtë platformë jepet me rubrika të caktuara ku sqarohet dhe pikëzimi duke rritur transparencën e vlerësimit. Gjithashtu, vlerësimi i plagjiaturës së punimeve, detyrave, artikujve apo dhe tezave kryhet me anë të testeve të plagjiaturës, si Turnitin, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi duke zbatuar format e vlerësimit të përmendura më sipër. Studentët nëpërmjet sistemit BIS kanë mundësi të shohin sillabusin si dhe format e vlerësimit, me të cilat njihen edhe në fillim të semestrit.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Shpallja e rezultateve të vlerësimeve të ndryshme shoqërohet me shpjegimet përkatëse dhe komente, sqarimin e përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Në rastet e nevojshme, pedagogu është i gatshëm të bëjë sqarime të mëtejshme për studentët që e kërkojnë këtë. Po ashtu, pedagogu mund të zhvillojë takime ose orë shtesë për përvetësimin e njohurive nga ana e studentëve të një lënde, ose me një grup të caktuar syresh. Gjithashtu, i gjithë procesi mësimor gjatë semestrit është i shoqëruar me vlerësimin joformal, formues të studentëve ku pedagogët japin feedback me gojë apo shkrim të prezantimeve, diskutimit të temave të ndryshme, shqyrtime rishqyrtime të detyrave, eseve apo artikujve para dorëzimit të tyre final.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk</p>	<p>KU “Bedër” nëpërmjet rregullores "Për disiplinën e studentëve", dënon kopjen dhe plagjiaturën e çfarëdollojshme. Kjo rregullore përbën</p>

⁹⁰ Evidenca nr. 5: Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”. neni 78






<p>lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>sanksionimin dhe dënimin e kopjes dhe plagjiaturës. Po kështu, kjo është e shënuar edhe në çdo syllabus lënde ... “Studenti është i detyruar të respektojë rregullat e etikës të përfshira në rregulloret e brendshme si Rregullorja e Disiplinës së Studentëve, Rregullat mbi Organizimin e Provimeve etj. Studenti mban përgjegjësi të plotë në çdo rast shkeljeje të rregullave lidhur me organizimin e provimeve, plagjiaturën, falsifikimin. Gjithashtu, mban përgjegjësi në rast të shkeljeve të të gjitha normave të tjera që rregullojnë marrëdhëniet mes studentëve me njëri-tjetrin dhe me personelin akademik dhe atë mbështetës.” Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Për më tepër, zhvillimi i provimeve në auditorë realizohet me prezencën e dy mbikëqyrësve për të minimizuar plagjiaturën.</p> <p>Personeli akademik përgjegjës për punime të ndryshme detyrash dhe tezash bën kontrollat e duhura të plagjiaturës edhe me anë të platformave të disponueshme falas dhe me pagesë, përfshirë Turnitin. Kopjimi dënohet me masë disiplinore deri në pezullimin e së drejtës për të vazhduar studimet në Kolegjin Universitar “Bedër”, parashikuar dhe në Rregulloren për disiplinën e studentëve.⁹¹</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kolegji Universitar “Bedër” bën të ditur kalendarin e tij akademik në fillim të çdo viti akademik. Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik. Ky kalendar pasqyrohet edhe në sistemin e brendshëm BIS, i cili është mënyra zyrtare e afishimit të rezultateve. Stafit akademik është i detyruar të ndjekë kalendarin sipas rregullores së sistemit dhe finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit të automatizimit BIS.</p> <p>Studentët vlerësohen bazuar në një kombinim formash të vlerësimit në të folur dhe shkruar, vlerësim i vazhdueshëm dhe përfundimtar, vlerësim formal dhe joformal duke i dhënë mundësi shprehjes së njohurive, aftësive dhe kompetencave.^{92 93}</p> <p>Në fund të semestrit pedagogu i lëndës dorëzon dosjen e provimit, e cila është e plotë në përmbajtje duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare, sipas rregullores përkatëse.⁹⁴</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve publikohen në sistemin BIS. Sipas rregullores së programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>, studenti ka të drejtë të njihet me vlerësimin e merituar dhe mbi çfarë ai bazohet.⁹⁵</p>

⁹¹ Evidenca nr. 53: Rregullorja e Disiplinës së Studentëve të Kolegjit Universitar “Bedër”

⁹² Evidenca nr. 42: Guida e Stafit

⁹³ Evidenca nr. 43: Guida e Studentit

⁹⁴ Evidenca nr. 4 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, neni 36

⁹⁵ Evidenca nr. 7: Rregullorja e Programit të Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asca.al



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

	Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. ⁹⁶			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Ankimi i një studenti shqyrtohet nga një komision, i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash, duke hedhur dritë mbi gabimet e mundshme materiale. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim të vlerësimit. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren përkatëse të studimeve të ciklit të dytë. ⁹⁷ Vendimi dhe përfundimet e komisionit dokumentohen dhe arkivohen pranë departamentit nuk ka pasur raste ankimimi note.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> ofron njohuri bazë dhe specifike në këtë fushë. Krahas teorisë, seminareve, projekteve, rasteve studimore dhe praktikave profesionale, përmes marrëveshjeve me shkolla të ndryshme, studentët bëjnë praktika profesionale mësimore. Duke marrë parasysh rëndësinë që i kushtohet praktikës profesionale, për monitorimin e mbarëvajtjes së tyre është hartuar edhe një paketë dokumentacioni me formularët e nevojshëm për t’u plotësuar gjatë ndjekjes së praktikës profesionale nga ana e studentëve, duke përfshirë formular i vlerësimit të studentit praktikant, formular i miratimit të praktikës, raport mbi zhvillimin e praktikës, si dhe raportime të përjavshme në lidhje me zhvillimin e procesit të praktikës në shkollat përkatëse. ⁹⁸
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).	Programi i Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është i fokusuar në përfshirjen e risive në shkencat humane dhe të mësimdhënies. Staf i kujdeset të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset në mënyrë periodike, në përputhje me kërkesat e kohës, duke i kushtuar vëmendje përfshirjes së teknologjisë më të fundit në dispozicion, sidomos në gjuhën angleze, kur merret parasysh profili i programit. Vlen të përmendet përfshirja e lëndës “Teknologjitë Mësimore në Edukim”. ⁹⁹

⁹⁶ Evidenca nr 88: Procedurë për Ankimimin e Notës

⁹⁷ Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

⁹⁸ Evidenca nr. 27: Procedurë e Praktikës Profesionale

⁹⁹ Evidenca nr. 19: Syllabus-et e Lëndëve të Programit

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: fo@







<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të semestrit, lektorët sigurohen që me anë të metodave të ndryshme vlerësuese të aplikuara (përfshirë këtu vlerësimin e vazhdueshëm në forma të ndryshme dhe vlerësimin përfundimtar) që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe plotësuar.</p> <p>Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku si pedagogët ashtu edhe studentët shprehin mendimet e veta për njohuritë dhe shprehitë e fituara, çfarë i vlen pedagogut për të nxjerrë konkluzione për përmirësimin e procesit në vijimësi.</p> <p>Një praktikë e suksesshme e Programi i Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> është prezantimi i projekteve individuale dhe praktikave profesionale, të cilat janë mënyra të pavarura dhe shumë efektive për përvetësimin e çështjeve të trajtuara në syllabus-e.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikave profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirë përcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit të Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme që të zhvillojnë aftësitë e veta, përfshi aksesin në laboratorë kompjuterike dhe praktika profesionale. Institucioni mban kontakte me zyrat arsimore vendore si dhe ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione jo-publike të mësimdhënies.¹⁰⁰</p> <p>Këto marrëveshje mundësojnë organizimin e praktikave të studentëve, zhvillimin projekteve të përbashkëta, si dhe u hapin rrugë bashkëpunimeve të tjera në funksion të realizimit të aktivitetit dhe objektivave të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik dhe në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore, departamenti harton një plan aktivitetesh,¹⁰¹ ndër të cilat përfshihen. leksione të hapura¹⁰², seminare trajnuese e workshop-e. Studentët, gjithashtu, marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë kurrikulare, si konferenca¹⁰³, orë të hapura, workshop¹⁰⁴, aktivitete të ndryshme trajnimit të mbajtura me pedagogë dhe /ose specialistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.</p> <p>(https://edueng.beder.edu.al/sh/news/activities_list/).</p> <p>Të ftuarit në këto orë jashtë kurrikulare dhe të hapura mund të jenë staf i brendshëm ose i jashtëm, specialistë të fushës dhe ekspertë nga universitete brenda e jashtë vendit. Një praktikë shumë e mirë në këto seminare dhe orë të hapura është përfshirja e temave ndërdisiplinore.</p>

¹⁰⁰ Evidenca nr. 83: Lista e Institucioneve me të cilat KU “Bedër” ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fusha të Ndryshme

¹⁰¹ Evidenca nr. 64: Plani i Aktiviteteve të Departamentit, 2022-2023

¹⁰² Evidenca nr. 61: Orë e Hapur me Peter Schadt Ph.D. University of Tubingen

¹⁰³ Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Viti Akademik 2021-2022

¹⁰⁴ Evidenca nr. 92: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Woei Hung, bashkë me linqet përkatëse

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: fo@ascal.al







Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët përbën edhe një zë të veçantë në planin strategjik të institucionit, çfarë synon dhe zhvillimin profesional të studentëve, duke mbështetur idetë e tyre inovative dhe kërkimore ¹⁰⁵ . KU “Bedër” mbështet studentët e tij dhe idetë e tyre përmes mbështetjes së ofruar për pjesëmarrje në projekte përfshirëse apo zhvillimin e ideve në projekte individuale, si detyra lëndësh të caktuara, në konferenca studentore, si dhe nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në konferenca ndërkombëtare. Studentët e programit në fjalë kanë marrë pjesë si bashkautorë me pedagogët e tyre në konferencën ndërkombëtare ICESS të organizuar nga njësi bazë ku ky program bën pjesë. Vlen të përmendet se studentët tanë janë përjashtuar nga pagesa për pjesëmarrje në konferencë. ¹⁰⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Diplomimi është një proces i mirë organizuar përmes procedurave dhe rregulloreve të miratuara nga institucioni. Ai është pjesë e Rregullores Themelore të Institucionit ¹⁰⁷ , Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të dytë ¹⁰⁸ , Rregullores së Programit të Studimit ¹⁰⁹ , ku saktësohen dhe detyrimet që studentët duhet të përmbushin deri në diplomimin e tyre. Udhëzimi për shkrimin e tezës është i publikuar në faqen e institucionit ¹¹⁰ dhe është i aksesueshëm nga të gjithë studentët. Punimi i diplomës së studentëve të programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> realizohet në kuadër të lëndës semestrale. Një punim i detyrueshëm diplomimi nga ana e studentit në përputhje me programin e studimit, tregon arritjen e një niveli të kënaqshëm profesional.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	KU “Bedër” bën publik informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së diplomave në përputhje me rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë. ¹¹¹ Udhëheqësit e diplomave kanë rol kyç në përcjelljen e këtij informacioni. Gjithashtu, pjesë e manualit për përgatitjen e punimit të diplomës dhe kriteret e vlerësimit të punimit për studentët e ciklit të dytë

¹⁰⁵ Evidenca nr. 8: Plani Strategjik Institucional i KU “Bedër”. 2018-2023

¹⁰⁶ Evidenca nr. 72: Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU Bedër

¹⁰⁷ Evidenca nr. 5: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”

¹⁰⁸ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

¹⁰⁹ Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*
¹¹⁰ Evidenca nr. 73: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët të Ciklit të Dytë

¹¹¹ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.ascal.al


	<p>gjendet dhe në Manualin për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të dytë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Përgatitja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit në përputhje me programin e studimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësisë përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të katërt në këtë program. Punimi i diplomimit mund të parashikohet edhe në përmbajtjen e ndonjë lënde të caktuar të programit. Bazuar në elementët e vlerësimit të tezës, komisioni i ngritur posaçërisht bën vlerësimin sipas peshës specifike.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës dhe këshilltari akademik kanë rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi, siç sqarohet dhe në udhëzuesin përkatës¹¹². Mbështetja e udhëheqësit mund të shihet që nga përzgjedhja e temës, tek strukturimi i saj deri tek aplikimi i metodologjisë përkatëse dhe analizimi i të dhënave. Në përputhje me udhëzimin për përgatitjen e punimit të diplomimit, udhëheqësi mbështet studentët edhe në hartimin e konkluzioneve dhe përpilimin e listës përkatëse të literaturës të përdorur si referencë.¹¹³</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është udhëheqësi i diplomës. Ai asiston studentët edhe në mundësimin e nevojave të caktuara nga institucioni, në kuadër të përgatitjes me sukses të punimit të diplomës.</p> <p>Në bazë të vlerësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, roli i udhëheqësit është i mirë përcaktuar. Caktimi i udhëheqësve akademikë nga KU "Bedër", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje e me radhë në fushën studimore të temës së diplomës.¹¹⁴</p> <p>Gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës laboratorit i kompjuterëve dhe biblioteka qëndrojnë të hapura dhe në fundjavë.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti vlerësohet me notë nga një komision në përfundim të punimit të diplomës. Nota shfaqet në listën e notave të studentit. Përbërja e komisionit miratohet nga departamenti. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, specialistë të fushës së temës së përzgjedhur nga studenti.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në</p>	<p>Studenti, i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e parashikuara në kurrikulën përkatëse të programit të studimit dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në rregulloren e programit të studimit "Master profesional" në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për</i></p>

¹¹² Evidenca nr. 49: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik

¹¹³ Evidenca nr. 81: Formulari i Ecurisë së Tezës

¹¹⁴ Evidenca nr. 73: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë







përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , pajiset me diplomë dhe suplementin e saj. Kundrejt kërkesës së studentit, në përfundim të studimeve, institucioni, gjithashtu, vë në dispozicion kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, në përfundim të studimeve. ¹¹⁵			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas ligjit përkatës dhe rregullores në fuqi, institucioni ruan, për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar, kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet e konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, po në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi ¹¹⁶			
Shkalla e përmbushjes standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , bazuar në marrëveshjet e lidhura nga KU “Bedër” me institucione dhe shkolla të ndryshme shtetërore dhe jo shtetërore, mundëson realizimin e praktikave jashtë institucionit për studentët praktikantë ¹¹⁷ .
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Kolegji Universitar “Bedër” në bashkëpunim dhe partneritet garanton realizimin e praktikave me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Pedagogët e lëndëve, në të cilat përfshihet aplikimi praktik i njohurive jashtë institucionit bashkëpunojnë me kompani, të cilat kanë marrëveshje me KU “Bedër”.
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Kurrikula e këtij program studimi përfshin lëndën e Praktikës Profesionale, e cila zhvillohet në semestrin e dytë me një ngarkesë prej 12 ECTS dhe organizohet bazuar në Procedurën e Praktikës Profesionale ¹¹⁸ . Studentët e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , duhet të realizojnë periudhën e praktikës në një nga shkollat ku institucioni ka marrëveshje, apo në një shkollë të zgjedhur nga studenti për një periudhë 12 javore. Gjatë kësaj

¹¹⁵ Evidenca nr. 26 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

¹¹⁶ Evidenca nr. 38: Rregullorja e Arkivës

¹¹⁷ Evidenca nr. 83: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fjalë të Ndryshme

¹¹⁸ Evidenca nr. 27: Procedurë e Praktikës Profesionale

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@beder.edu.al



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

	periudhe, studenti sheh nga afër punën në terren, në rastin konkret në shkolla. Rezultatet e përvijës së praktikës profesionale reflektohen në dosjen e praktikantit ku gjendet materiale të ndryshme si plane tremestrale, plan ditore, plan vlerësimi, ese kritike, formularë observimi, etj. Dosja vlerësohet nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu studenti praktikant vlerësohet dhe nga mbikëqyrësi në vendin e praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Në programin e studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> , angazhohet personel efektiv me tituj e grada shkencore, si Prof.Asoc. Dr dhe Doktor shkencash në profilet e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, pedagogjisë e psikologjisë, si dhe shkencave shoqërore dhe humane, duke përmbushur kështu katërcipërisht kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. ¹¹⁹
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit	Stafit akademik efektiv mbulon 100 për qind të programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> dhe <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>

¹¹⁹ Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit






në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	KU “Bedër” dëshmon se personeli akademik është i qëndrueshëm pasi te gjithë lektorët e angazhuar në këtë program studimi kanë një periudhë punësimi të konsiderueshme pranë institucionit. Zyra e Burimeve Njerëzore pranë KU “Bedër” zotëron dokumentacionin e plotë të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi ¹²⁰ , duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. ¹²¹
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për rekrutimin e personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren Themelore, personeli akademik, ndihmës mësimesor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU “Bedër”. Staf i angazhuar në institucion dhe konkretisht në Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze, është përzgjedhur duke i kushtuar rëndësi të veçantë fushës së tyre të specializimit, në mënyrë që ata të përputhen dhe të kontribuojnë me zhvillimin e institucionit në përgjithësi dhe të departamentit në veçanti. ¹²²
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Programi në natyrën e tij nuk ka të përfshira orë laboratorike. Për mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni angazhon staf me kualifikime të posaçme, si ekspertë IT, etj.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore disponon një dosje të posaçme për çdo anëtar të personelit akademik dhe administrativ, të përditësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të dekanatit dhe miratim të rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti, ¹²³ në përputhje me udhëzimin përkatës ¹²⁴ .
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,	Në fillim të vitit akademik, Departamenti vendos një asistent pranë zyrës së planifikimit të karrierës. Ai së bashku me lektorin e lëndës së praktikës profesionale, mbështet dhe orienton studentët përgjatë procesit të përzgjedhjes së institucionit ku ata do të zhvillojnë praktikën. Ata mbajnë kontakt me zyrën përkatëse për mbarëvajtjen e procesit të praktikës që nga përzgjedhja e institucionit deri në përfundim të praktikës që

¹²⁰ Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e studimit

¹²¹ Evidenca nr. 74: Dosja e Stafit Akademik

¹²² Evidenca nr. 14: Procedura e Punësimit të Stafit

¹²³ Evidenca nr. 23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore

¹²⁴ Evidenca nr. 20: Udhëzim për Ngarkesën Mësimore

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al







<p>udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton pjesëmarrjen e studentit. Lënda e praktikave profesionale është e detyrueshme për të gjithë studentët e këtij programi studimi.^{125 126}</p> <p>Për sa i përket punimit të diplomave, departamenti bën ndarjen e temave dhe udhëheqësve në bashkërendim me studentët, ku secili student dërgon në departament propozimin për udhëheqësin dhe temën. Komiteti Shkencor bën shqyrtimin e tyre dhe përcaktohet udhëheqësi dhe tema.¹²⁷</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në mënyrë që pjesëmarrja, angazhimi dhe zhvillimi profesional i studentëve që kryejnë praktika nëpër institucione të tjera përveç ambienteve të Kolegjit Universitar “Bedër” të evidentohet, në përfundim të praktikës, studenti duhet të dorëzojë pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës si dhe pranë departamentit/pedagogut të lëndës së praktikës profesionale formularët e plotësuar nga vetë studenti duke shpjeguar dhe ilustruar pjesëmarrjen aktive në praktikë.</p> <p>Po ashtu, kërkohet dorëzimi i formularëve të plotësuar nga personi përgjegjës i kompanisë, në këtë rast shkollës dhe nga lektori i lëndës. Në to, vlerësohet pjesëmarrja dhe angazhimi i studentit në detyrat e caktuara.¹²⁸</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KU “Bedër” ofron mjedise të mjaftueshme që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla si laborator i kompjuterëve, newsroom, biblioteka etj, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e veprimtarive mësimore. (Shih tabelën 16 për të dhëna mbi infrastrukturën)</p>

¹²⁵ Evidenca nr. 27 Procedurë e Praktikës Profesionale

¹²⁶ Evidenca nr. 47: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin e Zyrat e Tjera

¹²⁷ Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

¹²⁸ Evidenca nr. 27: Procedurë e Praktikës Profesionale

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al







<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i>. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjuter, internet, etj. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi në fjalë nuk është i natyrës teknike, për të cilin të nevojiten laboratorë për punë eksperimentale. Për të përmbushur nevojat e programeve janë ngritur laboratorit e kompjuterëve, salla e multimedia-s, biblioteka, etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Natyra e programit nuk e ka te domosdoshme përdorimin e laboratorëve te avancuar të teknologjisë së informacionit, megjithatë institucioni disponon dy laboratorë të teknologjisë së fundit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Programi i studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: <i>Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët</i> nuk i realizon praktikat profesionale brenda institucionit. KU “Bedër” ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme arsimore, ku studentët zhvillojnë këto praktika profesionale,^{129 130} duke përmbushur qëllimin e tyre në mënyrë efikase.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

¹²⁹ Evidenca nr. 27: Procedurë e Praktikës Profesionale

¹³⁰ Evidenca nr. 83: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime të bashkuara të ndryshme

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al






Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Pedagogu i lëndës zgjedh dhe përditëson literaturën bazë dhe ndihmëse, në përputhje me specifikat e lëndës. Gjithashtu, kopje elektronike e literaturës së nevojshme në gjuhën angleze i jepet studentëve dhe bëhet e aksesueshme edhe virtualisht. Kjo praktikë garanton aksesimin e literaturës nga studentët dhe e bën më të lehtë për ta marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti në fillim viti u kërkon lektorëve literaturën me të cilën duhet të përditësojnë sylabuset, më pas kjo literaturë i dërgohet rektoratit dhe bibliotekës për të plotësuar nevojat me literaturën e kërkuar. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi. ¹³¹ Secili lektor u ofron mundësinë të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë të kenë akses të literaturës bazë në bibliotekë. Gjithashtu studentëve u ofrohen materiale në versionin PDF dhe nëpërmjet emailit të tyre institucional, ata mund të aksesojnë <i>JSTOR</i> , arkivën e pasur të revistave akademike me të cilën KU “Bedër” ka marrëveshje aktive ¹³² .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KU “Bedër” është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës, kurse gjatë sezonit të provimeve dhe në fundjavë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 35 000 tituj. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhje me programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër”, përfshirë edhe programin e studimit në fjalë. Krahas kësaj, pedagogët udhëzojnë studentët të aksesojnë revista akademike me akses të hapur. Biblioteka është e abonuar në platforma shkencore online, si <i>JSTOR</i> duke u mundësuar studentëve dhe stafit hyrjen e pa limituar dhe pa pagesë në këtë bibliotekë të pasur dhe përfshirëse të kalibrit ndërkombëtar. <i>JSTOR</i> mundëson përdorimin e më shumë se 12 milionë artikujve të revistave shkencore. ¹³³
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzimin të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, KU “Bedër” ka bërë marrëveshje dhe ka akses të plotë si nga ana e studentëve ashtu edhe nga ana e stafit në <i>JSTOR</i> , një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë thjeshtë përmes adresës së tyre të emailit të KU “Bedër”.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që	Biblioteka e KU “Bedër” është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjuterë për t’u mundësuar studentëve realizimin e detyrave dhe

¹³¹ Evidenca nr. 57 Udhëzim mbi Funkcionimin e Bibliotekës

¹³² Evidenca nr. 44 Marrëveshja për akses në *JSTOR*

¹³³ Evidenca nr. 57 Udhëzim mbi Funkcionimin e Bibliotekës

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al







mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	mundësi për akses online materialesh në varësi të nevojave të tyre. Po ashtu, databaza e Bibliotekës së KU “Bedër” gjendet online, duke i ndihmuar studentët në gjetjen e literaturës. ¹³⁴			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë të bëra publike në hyrje të bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. Në funksion të bibliotekës, KU “Bedër” ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online JSTOR - një bibliotekë digjitale për punime akademike, libra dhe burime informacioni sipas fushave specifike të studimit.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	KU “Bedër” parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës. Gjithashtu, departamenti në fillim të vitit akademik pas konsultimit me lektorët dërgon kërkesat për literaturën e nevojshme. ¹³⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me	BIS-i është sistemi i automatizimit që përdoret në KU “Bedër”. Sistemi BIS mundëson pasqyrimin, ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarive të shumta institucionale në mënyrë të automatizuar. Çdo pedagog, student dhe personel akademik ka një llogari në sistemin BIS, e cila u vihet në dispozicion, në

¹³⁴ Evidenca nr. 57 Udhëzimi mbi Funkcionimin e Bibliotekës

¹³⁵ Evidenca nr. 77: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.asca.al

 E-mail: info@asca.al






studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	momentin e punësimit, nga zyra e IT-së. Në modulet e ndryshme të sistemit BIS janë të ruajtura të dhënat dhe rekordet për secilin student që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, duke qenë në gjendje të pasqyrojnë në mënyrë të detajuar vlerësimin, frekuentimin, shpalljen e studentëve kalues ose jo në çdo lëndë, rimarrjen e një lënde, dhe shpërndarjen përkatëse të ECTS-ve të grumbulluara sipas viteve, me qëllim ndjekjen e ecures së studentëve dhe shpalljen e tyre kalues ose jo, në përputhje me rregulloren e ciklit të dytë të studimeve.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	BIS është sistemi i automatizimit që përdoret në KU “Bedër”. Sistemi BIS mundëson pasqyrimin, ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarive të shumta institucionale në mënyrë të automatizuar. Të gjitha njësitë kanë një llogari në këtë sistem, ku bëjnë veprimet në lidhje me përgjegjësitë përkatëse. Në BIS ka një llogari për secilën nga njësitë e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> ● Studentët; ● Stafin akademik; ● Zyrë e burimeve njerëzore; ● Zyrën e sekretarisë mësimore; ● Bibliotekën; ● Sekretaritetë e departamenteve; ● Zyrën e financës dhe çështjeve administrative; ● Zyrën e marrëdhënieve me publikun dhe median; ● Zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Si i tillë, sistemi BIS mundëson administrimin dhe qarkullimin e informacionit dhe gjurmimin e aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. ¹³⁶
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i automatizuar i informacionit, përmes moduleve të dedikuara dhe të konceptuara për t’u ardhur në ndihmë studentëve, personelit akademik dhe ndihmësakademik, atij administrativ dhe përgjegjësve për administrimin e të dhënave, mundëson akses të njëkohshëm në dokumente, të dhëna dhe informacione për të gjitha palët e interesuara të përfshira në procesin akademik apo në proceset administrative që kanë të bëjnë me koordinimin e programeve të studimit.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i automatizuar BIS, gjithashtu mundëson qarkullimin në kohë reale dhe sinkronizimin e të dhënave, si dhe transferimin e tyre nga njëra njësi tek tjetra dhe nga njëra palë e interesuar tek tjetra, me qëllim mbajtjen dhe ofrimin e të dhënave të përditësuara njësisive institucionale dhe studentëve në çdo kohë.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Ashtu sikundër u përmend dhe më sipër, sistemi i automatizuar i menaxhimit të informacionit, me modulet e tij përgjegjëse, për të mbështetur veprimtarinë e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Një shembull i kësaj është qarkullimi çdo fillim semestri në kohë reale i të dhënave në lidhje me studentët që kanë arritur të regjistrojnë lëndët për semestrin përkatës dhe në lidhje me ato që për mangësi

¹³⁶ Evidenca nr. 35 Udhëzues i Sistemit Informativ (BIS)






	të caktuara dokumentacioni nuk arrijnë të regjistrojnë lëndët deri në plotësim të dokumentacionit të nevojshëm.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të institucionit gjendet informacion i përditësuar në lidhje me njësitë akademike dhe administrative, programet e studimit, burimet njerëzore, personelin akademik dhe administrativ të përfshirë në secilin program, si dhe veprimtaritë e njëjësive përkatëse. Në faqen web ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët, duke përfshirë kalendarin akademik, orarin e leksioneve dhe provimeve, si dhe një akses i dedikuar për bibliotekën, zyrën e kërkimit shkencor dhe zyrën e koordinimit të programeve master. Gjithashtu, në hapësirat e dedikuara të kësaj faqe, publikohen njoftime të ndryshme, përfshi njoftime pune apo njoftime për praktika profesionale, si dhe rezultate të anketave të zhvilluara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë apo komisioneve të tjera që operojnë pranë KU “Bedër”. I gjithë informacioni ofrohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. (edueng.beder.edu.al)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit, fondacioni “Hafiz Ali Korca” harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. Në raport paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit. KU “Bedër” gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Një mbështetje e madhe financiare për institucionin janë donacionet. Institucioni siguron që të ketë të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, si pasqyrohet në buxhetin e alokuar për departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze. ¹³⁷

¹³⁷ Evidenca nr. 77: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Projekt buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze pasqyron të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që departamenti ka, dhe të cilat janë detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Në projektbuxhet janë specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për shërbimet që departamenti ofron, në mënyrë direkte apo indirekte.</p> <p>Gjithashtu, të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, etj gjendet në raportet e zyrës së financës. (Shih Tabelën 18.)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Çdo vit, një kontabilist i miratuar harton një raport të situatës financiare të fondacionit “Hafiz Ali Korca” dhe ky raport ruhet pranë Fondacionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Raportet financiare hartohen nga fondacioni në fjalë, pjesë e të cilit është edhe KU “Bedër”, në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, KU “Bedër” i paraqet çdo Ministrisë së Arsimit dhe Sportit raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik¹³⁸, si edhe projektbuxheti afatmesëm.¹³⁹</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KU “Bedër” gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e deritanishme, KU “Bedër” dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe, bashkë me mbështetjen e donatorëve, ka kapacitete të mjaftueshme financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në rast se, në të ardhmen lind nevoja që të ndërhyhet për përmirësimin e situatës financiare.</p> <p>Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU “Bedër” bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, në ligjin nr. 87, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”; në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

¹³⁸ Evidenca nr. 77: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze

¹³⁹ po aty







V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Studentët e rinj pranohen në programet e ciklit të dytë në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”¹⁴⁰ dhe në bazë të kriterëve të miratuara për pranimin e studentëve¹⁴¹. Duke filluar nga momenti i regjistrimit dhe nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të studimeve, studentët kanë mundësi t’u drejtohen strukturave dhe njësive të institucionit që merren me informimin, orientimin, këshillimin dhe ankimimin.^{142 143} I gjithë procesi rregullohet me anë të politikave dhe procedurave përkatëse që nga pranimi i studentëve deri në diplomim. KU “Bedër” i kushton një rëndësi të veçantë procesit mësimor dhe vazhdimësisë së studimeve për secilin student duke mbajtur një raport numerik personel akademik-student, në mënyrë që çdo proces dhe nevojë e studentëve të jetë e plotësueshme dhe e realizueshme.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KU “Bedër” ndjek politika dhe procedura të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët . Çdo vit KU “Bedër” harton kriteret e pranimi për studentët rinj të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit dhe gjithashtu në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Nga ana tjetër, kriteret e nevojshme për t’u plotësuar nga ana e studentëve me qëllim kalimin e tyre nga njëri vit akademik në tjetrin dhe për diplomim parashikohen dhe janë publike për studentët në Rregulloren Themelore dhe në rregulloren e ciklit të dytë. KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. KU “Bedër” ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe studentë që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj. (www.beder.edu.al)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Për programet master, procedurat e pranimi të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimi, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit dhe përmes formave të tjera të promovimeve si panairi “Work and Study”.</p>

¹⁴⁰ Evidenca nr 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

¹⁴¹ Evidenca nr. 13: Praktika e Ndjekur për Miratim të Kriterëve të Pranimi të Studentëve

¹⁴² Evidenca nr 5: Rregullorja themelore e KU “Bedër”

¹⁴³ Evidenca nr 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profilitet të lartë për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al






<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>KU “Bedër” në kuadër të transparencës, kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përbajtjen e programeve Master që ofron. Sa më sipër, njësitë bazë kanë faqet e tyre të internetit, të cilat mund të aksesohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njëjësive kryesore apo atyre bazë, siç janë faqet e fakulteteve apo departamenteve. Në këto faqe ka një paketë të gjerë transparence në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, këshillat e departamenteve, etj. (https://edueng.beder.edu.al/)</p> <p>Po ashtu, procedurat, përzgjedhjet e studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare, dhe në platformën që administrohen nga KU “Bedër”. Këto informacione mund të sigurohen edhe përmes sekretarive të departamenteve, sekretarisë mësimore, apo pranë zyrës së pranimit.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë periudhës së aplikimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj, KU “Bedër” paraqet kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të çdo programi studimi në dy forma: me anë të webit ku studentët dhe jo vetëm, mund të aksesojnë informacionin në çdo kohë në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke marrë informacionin e nevojshëm rreth departamentit përkatës dhe programit të studimit për të cilin janë të interesuar; forma e dytë e informimit bëhet gjatë pjesëmarrjes nëpër panaire, ku marrin pjesë aplikantë¹⁴⁴ si dhe mirëpritjes së studentëve në ambientet e institucionit për të parë nga afër infrastrukturën dhe njësitë bazë¹⁴⁵. Në këtë formë të interesuarit informohen rreth kriterëve të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe brenda periudhave të parashikuara nga institucionet përkatëse, KU “Bedër” bën publike kuotat¹⁴⁶ si dhe kriteret¹⁴⁷ e pranimit për përzgjedhjen e studentëve me aftësi të veçanta e ndryshe, por edhe për përfshirjen konkrete të studentëve që i përkasin grupeve dhe komuniteteve të pak përfshira apo të marginalizuara. KU “Bedër” ka ndërmarrë hapa konkrete për përfshirjen e shtresave në nevojë dhe të marginalizuara, përmes bursave të studimit pasqyruar në rregulloren përkatëse¹⁴⁸.</p> <p>Krahas bursave të ekselencës, të talentit, POSIP, KU “Bedër” ofron edhe bursa të kategorisë sociale që përfshijnë studentët me status invalidi, paraplegjiku, tetraplegjiku, etj.</p> <p>(https://www.beder.edu.al/sh/content/default/bursat-e-studimit-6/6/154)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe brenda periudhave të parashikuara nga institucionet përkatëse, KU “Bedër” bën publike kuotat si dhe kriteret e pranimit për përzgjedhjen e studentëve që nuk janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë.</p>

¹⁴⁴ Evidenca nr 85: Pjesëmarrja në Panairin “Work and Study”

¹⁴⁵ Evidenca nr. 86: “Open Day” pranë Ambienteve të KU “Bedër”

¹⁴⁶ Evidenca nr. 67: Praktika e Ndjekur për Miratimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve

¹⁴⁷ Evidenca nr. 13: Praktika e Ndjekur për Miratim të Kriterëve të Pranimit të Studentëve

¹⁴⁸ Evidenca nr. 70: Rregullorja mbi Zbritjet e Tarifave të Studimeve

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asca.al







<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve të programit gjenden në faqen zyrtare të institucionit dhe departamentit. Ato përmbajnë informacion në lidhje me zërat e vlerësimit, objektivat, temat që do të zhvillohen etj.¹⁵⁵ Studentët prezantohen me lëndët gjatë javës së parë të studimeve.</p> <p>Këto të dhëna gjenden gjithashtu dhe në sistemin BIS, ku studentët mund të kontrollojnë në kohë reale të dhënat e përmendura më sipër si dhe pjesëmarrjen në leksione dhe seminare, notat, pikët dhe mesataren në fund të semestrit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat në lidhje me punimin e tezës dhe diplomimin e studentëve janë të shpjeguara në rregulloren e programit si dhe në rregulloren e ciklit të dytë të studimeve. Studentët pajisen me këtë informacion gjatë javës së parë të studimeve.</p> <p>Gjithashtu, lëndët e detyrueshme “Metoda Kërkimore” dhe “Teza” i dedikohen tërësisht punimit të diplomës. Çdo student ka një udhëheqës shkencor me të cilin kryen seanca konsultimi përgjatë semestrit të katërt, në vitin e dytë të studimeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>KU “Bedër” komunikon dhe mban lidhje me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe merr pjesë në panairt e zhvilluara në qytete të ndryshme, ku u prezanton programet, tarifat e studimit dhe bursat e ofruara për atë vit akademik. Këto të dhëna publikohen gjithashtu dhe në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale, në broshura dhe katalogë të ndryshme.¹⁵⁶ “Open Day” është gjithashtu një formë informimi për studentët e ardhshëm të cilët janë të mirëpritur të vizitojnë ambientet e KU “Bedër” dhe të takojnë nga afër përfaqësues të departamenteve për të cilat ata shprehin interes.¹⁵⁷</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të semestrit të parë akademik, studentëve u jepet mundësia të prezantohen dhe takohen me dekanin e fakultetit, shefin e departamentit dhe stafin akademik.¹⁵⁸ dhe të njihen në mënyrë të detajuar me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Përveç takimeve që zhvillohen javën e parë, studentët ndiqen përgjatë gjithë vitit të studimit nga Këshilltari Akademik.¹⁵⁹ Bazuar në udhëzuesin për këshilltarin akademik, ai jep informacion të mëtjeshëm në lidhje me</p>

¹⁵⁵ Evidenca nr. 19: Syllabus-et e Lëndëve të Programit

¹⁵⁶ Evidenca nr. 85: Pjesëmarrja në Panairin “Work and Study”

¹⁵⁷ Evidenca nr. 86: “Open Day” pranë Ambienteve të KU “Bedër”

¹⁵⁸ Evidenca nr. 68: Programi i Ditëve të Orientimit


¹⁵⁹ Evidenca nr. 46: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al



	procesin mësimor dhe çdo çështje që lidhet ngushtë me vazhdimësinë e studimeve. ¹⁶⁰
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përgjatë javës së orientimit studentët njihen me lëndët që do të zhvillojnë dhe informacionet e nevojshme nga secili pedagog, njihen nga afër me njësinë bazë dhe lektorët që lektrojnë tek programi i përzgjedhur prej tyre, me kurrikulën, laboratorët, dhe infrastrukturën në dispozicion, sistemin e automatizuar BIS, si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat e personelit. Këto të dhëna ata mund t'i aksesojnë në çdo kohë edhe në faqen zyrtare të institucionit në rubrikën e programeve të studimit ku paraqiten të gjitha modulet me silabusin përkatës dhe zërat e vlerësimit. Për më tepër, me anë të llogarisë së tyre personale të emailit, studentët aksesojnë sistemin BIS për të ndjekur lëndët, pjesëmarrjen e tyre përgjatë javëve të semestrit dhe rezultatet. Sekretaria e departamentit dhe Guida e Studentit janë gjithashtu në dispozicion të studentëve. ¹⁶¹
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Planifikimit të Karrierës, nën Dekanatin e Studentëve merret ngushtësisht me orientimin dhe informimin e studentëve drejt mundësive që ofron tregu i punës. Çdo departament cakton një anëtarë të tij pranë zyrës së planifikimit të karrierës me rolin e këshilltarit të karrierës. ¹⁶² Në bashkëpunim me zyrën, këshilltari i karrierës asiston me informacion përgjatë zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve të departamentit dhe orienton në pjesëmarrje dhe aplikime në pozicionet e internshipit apo pozicione pune të ofruara nga zyra e karrierës dhe institucioneve të ndryshme në tregun e punës. ¹⁶³ Gjithashtu, Zyra e të Diplomuarve zhvillon takime me ish të diplomuarit dhe mban kontakte dhe evidenca të punësimit të tyre në treg. ¹⁶⁴
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në javën e parë, studentët njihen nga afër me njësinë bazë dhe lektorët që lektrojnë tek programi i përzgjedhur prej tyre, me kurrikulën, laboratorët, dhe infrastrukturën në dispozicion, sistemin e automatizuar BIS, si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat përkatëse. Përveç informacioneve dhe sesioneve informuese në javën e parë të vitit akademik, studentët kanë në dispozicion linkun (tt.beder.edu.al) ku mund të kontrollojnë orarin mësimor në çdo kohë. Ata gjithashtu lajmërohen me anë të emailit nga sekretariatit dhe zyrat administrative për çdo njoftim, aktivitet, trajnim apo dokumentacion të nevojshëm.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Zyra e IT pajis me adresë emaili institucionale studentët që sapo kanë nënshkruar kontratën e studimit. çdo anëtar i personelit të KU "Bedër" zotëron një adresë institucionale me të cilën kryen çdo komunikim të nevojshëm me studentet dhe me stafin. Këto posta elektronike kanë një strukturë gjithëpërfshirëse: Emailt e studentëve: Shkronja e parë e emrit, mbiemri, viti i regjistrimit dhe @beder.edu.al. Emailt e stafit: shkronja e parë e emrit, mbiemri dhe @beder.edu.al.

¹⁶⁰ Evidenca nr. 49: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik

¹⁶¹ Evidenca nr. 43: Guida e Studentit

¹⁶² Evidenca nr. 47: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe përkohshëm Koordinatorin të Karrierës, Zyra e Tjera

¹⁶³ Evidenca nr. 60: Raport i Zyrës së Planifikimit të Karrierës

¹⁶⁴ Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa». Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al






	Sistemi i informimit BIS është i lidhur me Gmail në domainin @beder.edu.al dhe mund të aksesohet në çdo kohë dhe distancë. Me anë të tij realizohet shpërndarja e informacionit në kohë reale. Njoftime të rëndësishme jepen dhe nëpërmjet faqes së zyrës në web dhe llogarive në mediat sociale për të gjithë të interesuarit. ¹⁶⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarëve, në programin e studimit.	Për çdo student të regjistruar në KU “Bedër”, Zyra e Sekretarisë Mësimore mban dosjen individuale të secilit prej tyre dhe raporton statistikat e studentëve sipas programeve në çdo fund semestri. ¹⁶⁶ Në të njëjtën mënyrë, raportohen dhe të dhënat statistikore të studentëve të diplomuar. Gjithashtu, Zyra e të Diplomuarve zotëron një database më të gjitha kontaktet e të diplomuarve ndër vite, me anë të të cilave shpesh herë zhvillohen dhe aktivitete në bazë departamenti. ¹⁶⁷
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Dosjet individuale të studentëve që disponohen nga Zyra e Sekretarisë Mësimore përmbajnë informacion në lidhje me regjistrimin në një nga programet e studimit, të dhëna deri në përfundim të studimeve ose tërheqje nga programi përpara përfundimit të tij. Këto informacione mund të gjenden dhe në sistemin BIS, po ashtu dhe pranë sekretarive të departamenteve. ^{168 169}
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në mënyrë hard copy nga Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe nga departamenti përkatës dhe në mënyrë digjitale nga sistemi BIS. Të dhënat nga dosjet individuale që gjenden pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore analizohen nga kjo njësi dhe gjenerohen në sistemin BIS, informacione të cilat mund t’i aksesojë njësia në fjalë dhe këshilltari akademik. ^{170 171}
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm)	Institucioni , kontrollon periodikisht gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë

¹⁶⁵ Evidenca nr. 43: Guida e Studentit

¹⁶⁶ Evidenca nr. 26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

¹⁶⁷ Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve

¹⁶⁸ Evidenca nr. 36: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-22

¹⁶⁹ Evidenca nr. 26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

¹⁷⁰ Evidenca nr. 49: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik

¹⁷¹ Evidenca nr. 35: Udhëzuesi i Sistemit Informativ (BIS)

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al







të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. ¹⁷²			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Secili departament në fund të vitit akademik harton raportin vjetor të njësisë në të cilin shpalosen të dhënat e departamentit, ecuria e studentëve në secilin vit duke përfshirë informacion nga periudha e regjistrimit deri në punësim të tyre. Ky raport është gjithashtu pjesë e raportit institucional i cili dorëzohet pranë Ministrisë së Arsimit. Në fund të raportit të njësisë bazë është një seksion në lidhje me analizën SWOT me qëllim evidentimin dhe përmirësimin e nevojave të njësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët e KU “Bedër” janë të përfshirë në Senatën Akademik, pranë NJSBC, Komisionit të Përhershëm të garantimit të cilësisë dhe pjesëmarrës në këshillin e departamentit dhe fakultetit. ¹⁷³ Një njësi kyçe në garantimin dhe vazhdueshmërinë e angazhimit të studentëve është Dekanati i Studentëve, njësi e cila së bashku me zyrat përbërëse ndihmojnë dhe përfshijnë studentët që nga momenti i regjistrimit e deri në fund të përfundimit të studimit duke ruajtur kontaktet edhe pas punësimit të tyre. Dekanati i Studentëve realizon detyrat e mësipërme me anë të këshillimit, realizimit të aktiviteteve sociale, mbrojtjen e të drejtave të studentëve, mundësimin e praktikave profesionale dhe orientimin drejt tregut të punës. Dekanati i Studentëve mundëson angazhimin e studentëve që dëshirojnë në një numër klubesh, ku studentët jo vetëm përfshihen në nisma sociale por edhe gjejnë shansin të zhvillojnë pasionet e veta apo/dhe të përmirësojnë talentet e tyre. ¹⁷⁴ Për më tepër, një rol të veçantë në institucion ka edhe Këshilli Studentor i cili përbëhet nga senatorët e secilit vit studimi, të përzgjedhur nga vetë studentët. ^{175 176}
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve	Në KU “Bedër”, studentët janë pjesë e mbledhjeve të këshillave të njësive bazë dhe kryesore, si dhe pjesë e grupeve të punës në proceset e

¹⁷² Evidenca nr. 51: Procedura për Auditim Periodik të Brendshëm

¹⁷³ Evidenca nr. 39: Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit dhe në Këshillat e Fakulteteve

¹⁷⁴ Evidenca nr. 79: Lista e Klubeve

¹⁷⁵ Evidenca nr. 40: Vendimi i Senatit për Miratimin e Ngritjes së Komisioneve të Përhershme

¹⁷⁶ Evidenca nr. 58: Të Dhënat e Këshillit Studentor


Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.asc.al

 E-mail: info@asc.al





<p>dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>akreditimit. Në bazë të rregullores mbi anketat dhe vlerësimet, KU Bedër siguron dhe mbështet studentët përmes proceseve të anketimit dhe vlerësimit siç vijon: anketë vlerësimi e studentit ndaj institucionit dhe ndaj stafit akademik.¹⁷⁷ Këto forma anketimi janë të vlefshme edhe për stafin akademik dhe administrativ ndaj institucionit. Në fillim të provimeve finale të çdo semestri akademik, me anë të sistemit BIS, studentët vlerësojnë pedagogët e tyre, metodologjinë e mësimdhënies dhe infrastrukturën.^{178 179} Këto të dhuna ruhen dhe procesohen nga sistemi duke bërë të ditur rezultatin pranë njësive bazë, por në të njëjtën kohë duke ruajtur konfidencialitetin e studentëve pjesëmarrës.^{180 181}</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>KU “Bedër” i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po ashtu edhe me aspektin akademik. Çdo fundviti, njësiti bazë dhe ato kryesore përgatisin raportin vjetor të cilin e dërgojnë në Rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimit të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT. Studentët kanë qenë përherë pjesëmarrës aktivë dhe pjesë e vendimmarrjes në takimet për riorganizimin e programeve të studimit apo mes të tjerash edhe në mbledhjet me në fokus ndryshimin e kurrikulës. Gjatë përgatitjes së raportit të akreditimit pjesë e grupit të punës është dhe një përfaqësues i studenteve. Me miratimin e politikës për përmirësimi e cilësisë së programeve të studimit, studentët do të jenë pjesëmarrës edhe me anë të anketës për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët e KU Bedër kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre në lidhje me ndershmërinë dhe barazinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të njohurive si dhe të ankohen në rast mungese dakordësie. E drejta e ankimit parashtrohet në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë. Kjo e drejtë u lind të gjithë studentëve në momentin që ata nuk janë dakord me vlerësimin e njohurive të tyre duke ankimuar dhe kërkuar rishikimin e vlerësimit. Pas analizimit të ankimeve, rezultatet u dorëzohen njësive bazë në zarf të mbyllur. Studentët mund të bëjnë ankimim edhe pranë sekretarive të departamentit.¹⁸²</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

¹⁷⁷ Evidenca nr. 30: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve


¹⁷⁸ Evidenca nr. 33: Anketa Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët

¹⁷⁹ Evidenca nr. 32: Anketë Vlerësimi e Mendimit të Studentëve ndaj Institucionit

¹⁸⁰ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

¹⁸¹ Evidenca nr. 82: Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale

¹⁸² Evidenca nr 88: Procedurë për Ankimin e Notës

Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	KU “Bedër” dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si njësi e saj kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Master” që ofron si dhe Guidën e Studentit për çdo çështje që lidhet me procesin mësimor. ¹⁸³ Përveç faqes zyrtare, studentët e KU “Bedër” informohen dhe me anë të zyrave të institucionit si: Zyra e Sekretarisë Mësimore, Zyra e Regjistrimeve, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve në varësi të Dekanatit të Studentëve, sekretarive mësimore të njësisive bazë si dhe këshilltarëve akademik. Asistimi i këtyre zyrave është i vazhdueshëm përgjatë gjithë vitit akademik. Sistemi Bis gjithashtu, vlen si një formë informimi ku studentët ndjekin performancën e tyre në lëndët e semestrit përkatës dhe rezultatet. Ata njihen me syllabuset e secilës lëndë gjatë javës së parë të vitit akademik dhe në vazhdimësi komunikimi bëhet nëpërmjet emailit institucional. ¹⁸⁴
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Këshilltari Akademik dhe Këshilltari i Karrierës janë të lidhur ngushtë me këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin në çështje që janë në lidhje me procesin mësimor. Këshilltari akademik përqendrohet më shumë drejt çështjeve që lidhen me informimin e studentëve dhe vazhdimësinë e procesit mësimor, ndërsa këshilltari i karrierës është përgjegjës për informimin e mundësive të ndryshme si trajnime, seminare, leksione të hapura, mundësi punësimi, aplikime për praktikë profesionale etj. ^{185 186}
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Planifikimit të Karrierës në KU “Bedër” ka si funksion orientimin dhe këshillimin e studentëve drejt praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit në tregun e punës. Çdo departament emëron një këshilltar karriere pranë zyrës së karrierës, i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e kësaj zyre, informojnë studentët për mundësitë e trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve me karakter të zhvillimit profesional të zhvilluara brenda dhe jashtë institucionit. Përveç orientimit, një rol i rëndësishëm i zyrës së planifikimit të karrierës është edhe asistimi gjatë procesit të zhvillimit të praktikës profesionale. Çdo program i ciklit të dytë përmban një lëndë të detyrueshme “Praktikë Profesionale/Mësimore” në kurrikul. Studentët marrin informacion nga zyra si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për praktikë pranë institucioneve të tjera. ¹⁸⁷

¹⁸³ Evidenca nr. 43: Guida e Studentit

¹⁸⁴ Evidenca nr. 19: Syllabuset e Lëndëve të Programit

¹⁸⁵ Evidenca nr. 47: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin e Zyrat e Tjera

¹⁸⁶ Evidenca nr. 49: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik

¹⁸⁷ Evidenca nr. 27: Procedurë e Praktikës Profesionale

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve që funksionojnë në varësi të Dekanatit të Studentëve, përgatisin raporte vjetore me të dhëna në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale, marrëveshjeve të KU “Bedër” me kompani dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve bachelor dhe master. Këto raporte periodike dorëzohen dhe vihen në dispozicion pranë autoriteteve drejtuese përkatëse. ^{188 189}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Kolegji Universitar “Bedër” ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, të cilat përfshijnë elementë të vlerësimit, angazhimit të studentëve, trajtimit gjithëpërfshirës e të barabartë, etj. ¹⁹⁰
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse në KU “Bedër” zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. KU “Bedër” në çdo semestër organizon anketa me studentët për vlerësimin e stafit dhe lëndës. Gjithashtu stafi plotëson një formular vetëvlerësimi në fund të së cilit bëhet dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit për çdo lektor ¹⁹¹ Stafi akademik vlerësohet edhe me anë të formularit për vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Gjithashtu bëhet edhe një vlerësim në rang departamenti dhe fakulteti. Për stafin e ri, në momentin e rekrutimit pas leksionit të hapur, bëhet dhe një vlerësim nga komisioni përkatës ^{192 193 194}

¹⁸⁸ Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve

¹⁸⁹ Evidenca nr. 60 : Raport i Zyrës së Planifikimit të Karrierës

¹⁹⁰ Evidenca nr. 76: Udhëzuesi për Mësimdhënien Inovative

¹⁹¹ Evidenca nr. 31: Formulari i Vetëvlerësimit për Stafin Akademik

¹⁹² Evidenca nr. 54: Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies

¹⁹³ Evidenca nr. 14: Procedura e Punësimit të Stafit

¹⁹⁴ Evidenca nr. 50: Praktika e Ndjekur për Punësimin e Personelit Akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”


Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al






Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët janë të përfshirë në vlerësimin e metodave të mësimdhënies me anë të anketës semestrale për pedagogun dhe lëndën. Kjo anketë përfshin rubrika si vlerësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve, përgatitjen e pedagogut, etj. Të gjithë studentëve u garantohej e drejta për të ankimuar notën në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Kjo bazohet në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë dhe formularin e ankimimeve ^{195 196}				
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit të lëndës dhe pedagogut i përcillen nga rektorati përgjegjësve të departamenteve përkatëse. Gjithashtu, vlerësimi i njësisë, në bazë të raporteve të vetëvlerësimit i përcillet dekanatit dhe rektoratit. Rezultatet e anketave bëhen publike edhe në faqen e njësisë përkatëse. https://qac.beder.edu.al/surveys				
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në rezultatet e dala nga vlerësimet e stafit akademik KUB ka shpallur listën e stafit me performancën më të lartë për të dy fakultetet e tij. Me anë të kësaj, KU “Bedër” promovon praktikat më të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në KU “Bedër” kryhet me anë të këtyre strukturave: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës. Struktura dhe funksionimi i tyre janë të specifikuar në Statutin e KU “Bedër”, në rregulloren e NJSBC, rregulloret e komisioneve, dhe në procedurën për zhvillimin e kurrikulës,

¹⁹⁵ Evidenca nr. 33: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët

¹⁹⁶ Evidenca nr. 4: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë






	në përshtatshmëri të plotë me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit ^{197 198 199 200 201} .
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	KU “Bedër” është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj janë krijuar strukturat e përmendura më lart. Në përbërje të NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm të Cilësisë ka nga pesë anëtarë: tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm. Përmirësimi dhe siguri i vazhdueshëm i cilësisë zbatohet si pjesë e strategjisë institucionale. Gjithashtu janë hartuar Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe Politika e Përmirësimit të Programeve të studimit, të cilat parashikojnë përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ^{202 203 204 205} .
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Vlerësimi dhe siguri i cilësisë në KU “Bedër” realizohet me anë të sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë. KU “Bedër” ka kaluar me sukses 3 akreditime institucionale, në vitin 2013 nga APAAL, në vitin 2017 nga Agjencia Britanike e Akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL dhe të tretin në vitin 2021. Institucioni aplikon brenda afateve për akreditimin e programeve që ofron dhe realizon këtë proces nën koordinimin e NJSBC-së. Raportet e vlerësimeve të brendshme, të jashtme dhe vlerësimet përfundimtare janë bërë publike në faqen e institucionit https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions . Institucioni ka gjithashtu edhe një rregullore të anketave dhe të vlerësimeve, e cila rregullon procesin e mbledhjes së të dhënave dhe të përdorimit të tyre në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo rregullore parashikon marrjen e informacionit nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, stafit administrativ dhe nga studentët, si dhe analizimin e tij me qëllim rregullimin e procesit të vlerësimit të arsimimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi të ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër” ²⁰⁶ .
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësi, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse	KU “Bedër” kryen periodikisht vlerësimin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor me anë të treguesve të qartë dhe të matshëm, siç parashikohet në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve. Ky vlerësim realizohet me anë të formularit të vetëvlerësimit për stafin akademik, që plotësohet çdo fund viti akademik nga çdo anëtar i personelit akademikë. Ndër të tjera, formulari përmban të dhëna për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Vlerësimi i mësimdhënies realizohet edhe me anë pyetësorit të studentëve për pedagogun dhe lëndën në çdo fund semestri si dhe me anë

¹⁹⁷ Evidenca nr. 2: Statuti i KU “Bedër”. Kreu VIII, neni 28

¹⁹⁸ Evidenca nr. 28: Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e NJSBC

¹⁹⁹ Evidenca nr. 18: Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë

²⁰⁰ Evidenca nr. 41: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore Shkencore, neni 5

²⁰¹ Evidenca nr. 65: Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës

²⁰² Shih Tabelën 24

²⁰³ Evidenca nr. 8: Plani Strategjik Institucional i KU “Bedër”. 2018-2023

²⁰⁴ Evidenca nr. 94: Politika e Kolegjit Universitar “Bedër” për Cilësinë

²⁰⁵ Evidenca nr. 95: Politika për Përmirësimin e Cilësisë së Programeve të Studimit në KU “Bedër”

²⁰⁶ Evidenca nr. 30: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve, neni 3

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@beder.edu.al








për arritjet më të mira në programin e studimit.	të formularit të vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi i të dhënave nga këta instrumente realizohet në nivel njësie bazë dhe diskutohen nevojat në nivel individual dhe njësie duke bërë propozime përkatëse për përmirësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të veprimtarive që i shërbejnë akreditimit të programeve të studimit, KU “Bedër” përdor procese formale të miratimit, shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së tyre. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit kryhet në bazë departamenti sipas politikës për përmirësimin e programeve të studimit Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore propozohen nga njësisë bazë, duke kaluar më njësisë kryesore dhe më pas në Senat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së zhvillimit të kurrikulave sipas procedurës përkatëse. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm, rezultatet dokumentohen dhe u bëhen të ditura njësive bazë dhe vendimmarrëse, dhe pas evidentimit të mangësive hartohet plani i masave për përmirësim. Rezultatet janë të dokumentuara dhe u bëhen të ditura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit ²⁰⁷</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm shoqërohen me plane veprimi ku parashikohen rezultatet e vlerësimit, masat që do të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë dhe rezultatet e pritshme. Në këto plane veprimi gjithashtu caktohen njësitë përgjegjëse për ndjekjen e çështjes dhe periudha kohore e zbatimit.</p> <p>KU “Bedër” publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit (studentë, personel akademik dhe administrativ) në faqen e internetit të tij. Për sa u përket rezultateve të pritshme, KU “Bedër” ka bërë publik planin strategjik për periudhën 2018-2023. KU “Bedër” synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Për këtë arsye, vazhdimisht realizohen takime orientuese dhe informuese.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit,</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe cilësisë së programit të studimit KU “Bedër” përdor mënyra të drejtpërdrejta të vlerësimit të mësuarit dhe</p>

²⁰⁷ Evidenca nr. 78 Plani i Masave për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për Institucionin



<p>mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>mësimdhënies siç janë vlerësimi me notë për detyra dhe projekte, vlerësimi me pikë për pjesëmarrjen dhe aktivizimin në auditorë. Format e vlerësimit të mësimdhënies janë: Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët; Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Vlerësime të studentëve nga njëri-tjetri për nivelin dhe formën e angazhimit të tyre në punë e projekte të realizuara në grup; Vlerësime për testime ndërmjetëse të semestrit përkatës; Vlerësime për testime finale në përfundim të semestrit. Gjithashtu, është miratuar formulari i vlerësimit të vazhdueshëm²⁰⁸, i cili përfshin elementë si, silabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësim të detyrave dhe projekteve, etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>KU “Bedër” përdor metoda e instrumente të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit si:1) Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës e cila plotësohet në fund të çdo semestri dhe studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe lëndën. Në të përfshihen aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënit, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj. 2) Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit ku vlerësohen të gjitha shërbimet e ofruara dhe merren edhe rekomandime nga studentët për këto shërbime. 3) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit, ku merret vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara 4) Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit administrativ ndaj institucionit ku merren vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara në institucion. Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve merren masa për përmirësimin e shërbimeve dhe programit të studimit. 5) Anketë vlerësimi i studentëve për programin e studimit 6) Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit. Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve merren masa për përmirësimin e shërbimeve dhe të programit të studimit. Politika për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit parashikon edhe pjesëmarrjen e studentëve dhe të diplomuarve me anë të anketave (5 e 6 më lart) si dhe të bashkëpunëtorëve. ^{209 210 211 212 213 214}</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

²⁰⁸ Evidenca nr. 54: Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies

²⁰⁹ Evidenca nr. 33: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët

²¹⁰ Evidenca nr. 32: Anketë Vlerësimi e Mendimit të Studentëve ndaj Institucionit

²¹¹ Evidenca nr. 62: Anketa Vlerësuese e Stafit Akademik ndaj Institucionit

²¹² Evidenca nr. 63: Anketa Vlerësuese e Stafit Administrativ ndaj Institucionit

²¹³ Evidenca nr. 96: Anketa me Studentët e Programit për Cilësinë e Programit

²¹⁴ Evidenca nr 75: Anketë Vlerësimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit



Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas statutit të KU “Bedër”, Senati është organ kolegjal që vlerëson dhe garanton cilësinë e programeve të studimit, rektori dekanët dhe përfaqësues të asamblesë së fakulteteve janë pjesë e senatit. Gjithashtu Senati ngre komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë si dhe miraton zgjedhjen e anëtarëve të NJSBC, si dy organe përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në KU “Bedër”. Në të dyja këto struktura është siguruar përfaqësimi i stafit akademik nga të dy fakultet, i studentëve dhe i aktorëve të jashtëm. Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë realizohet edhe me anë të përfaqësimit të tyre në mbledhjet e departamentit që ofron programin e studimit si dhe në mbledhjet e këshillit studentor. Stafi i Kolegjit Universitar është kolektivisht përgjegjës për ruajtjen e standardeve akademike ²¹⁵ .
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë e dy strukturave të sigurimit të cilësisë, NJSBC dhe komisioni i përhershëm për garantimin e cilësisë, janë të parashikuara në rregulloret përkatëse. Gjithashtu çdo njësi, individ dhe student është përgjegjës për zbatimin e çdo detyre dhe përgjegjësie në varësi të pozicionit që ka në KU “Bedër”. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale, është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Këto struktura kryejnë dhe sigurojnë realizimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në analizat vjetore dhe seancat trajnuese mbi mbarëvajtjen e institucionit në fillim viti marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. KU “Bedër” synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Stafi akademik, administrativ dhe studentët bëhen pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm të programit.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe kryesisht Senati akademik e ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Një metodë e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe

²¹⁵ Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 89-90

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.ascal.al




diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në funksion të sigurimit të barazisë, KU “Bedër” ka miratuar edhe “Politikën për Barazinë Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet” ²¹⁶ .			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni përfshin në sigurimin e cilësisë aktorë të jashtëm nëpërmjet strukturave përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë. Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC-ja kanë në përbërjen e tyre një anëtar/ekspert të jashtëm. KU “Bedër” organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës. Edhe vlerësimi i brendshëm i programit përfshin përfaqësues të industrisë dhe të diplomuarve, të cilët japin vlerësime dhe mendime në lidhje me nevojat apo efikasitetin e njohurive të marra në program. Kjo përfshirje shprehet në politikën për përmirësimin e programeve të studimit, e cila e bën atë të detyrueshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë e organizuara në kuadër të përmirësimit të cilësisë të programit të studimit janë transparente dhe të aksesueshme për të gjithë të interesuarit dhe studentët në faqen e sigurimit të cilësisë https://qac.beder.edu.al/ . Studentët njihen me aktivitetet që kryhen në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, njoftohen me anë të emailit për të gjitha aktivitetet dhe përfshihen në to. https://qac.beder.edu.al/activities .
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Kolegji Universitar “Bedër” bën publike në faqen e internetit të gjitha rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke zbatuar legjislacionin në fuqi për të dhënat personale. Raportet e brendshme: https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	KU “Bedër” dhe njësitë bazë për programin e studimit rishikojnë vlerësimet e raporteve të jashtme dhe përgatitin plan veprimtar për

²¹⁶ Evidenca nr. 80: Politika e KU “Bedër” për Barazi Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet






masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	përbushjen e rekomandimeve me qëllim plotësimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe të institucionit ²¹⁷			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Informacioni i marrë nga instrumentet e ndryshëm për matjen dhe monitorimin e cilësisë janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë pjesë kryesore dhe bazë përkatëse. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen me stafin akademik dhe diskutohen për përmirësim të mëtejshëm të programeve. Varësisht këtyre rezultateve bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim, ose zhvillim të mëtejshëm sipas zyrave përkatëse dhe bëhet ndjekje e zbatimit të tyre. Vlejnë për t'u përmendur këtu monitorimi i zbatimit të plan-veprimeve të hartuara në kuadër të rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme, nga akreditimi i programeve të studimit, nga anketat e studentëve si dhe rishikimi i dokumentacionit me qëllim përmirësimin e cilësisë në vijim të auditimit të brendshëm që zhvillohet në institucion.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, NJSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre për përfshirje aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit me anë të plotësimit të anketave e formularëve përkatëse por edhe me anë të sugjerimeve. Gjithashtu, si personeli edhe studentët janë pjesë e GVB-ve për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Stafit dhe studentët informohen periodikisht në lidhje me procesin e vlerësimit dhe përmirësimin të cilësisë. Këto janë të pasqyruara edhe në faqen e NJSBC https://qac.beder.edu.al/activities .			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

²¹⁷ Evidenca nr. 78: Plani i Masave për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për Institucionin






PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*”

Pika të forta dhe afirmime

1. Programi i Studimit është hartuar mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, dhe bashkëkohor. Dokumenti i planit strategjik të zhvillimit të institucionit orienton drejt dhe në mënyrë objektive dhe me standarde zhvillimin në kontekstin e këtij programi me profil kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
2. Programi i Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*” ofron studime të një cilësie të lartë dhe garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat dhe profilin e përcaktuar. Programi është ndërtuar në përputhje me vizionin dhe misionin e KU “Bedër”, nevojat e tregut, objektivat e reformës për arsimin e lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës dhe ka të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore vendase dhe të huaj.
3. Programi i Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*” mbështetet dhe i referohet përvojave më cilësore të institucioneve të arsimit të lartë në mbarë botën dhe është strukturuar në mënyrë që të përkujdeset për studentët deri në nivelet më të larta të kualifikimit. Përgatitja e studentëve bëhet duke u bazuar në teoritë më të fundit të të nxënit dhe të mësimdhënies.
4. Mësimdhënia në departamentin e Edukimit dhe Gjuhës dhe Angleze e po ashtu në Programin e Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*” zhvillohet ekskluzivisht në gjuhën angleze, çfarë i përgatit studentët për tregun e punës në vend dhe atë ndërkombëtar.
5. Stafi akademik efektiv dhe me kontratë në Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze, e si rrjedhojë stafi i përfshirë në programin e studimit në fjalë ka eksperiencë afatgjatë studimi dhe mësimdhënieje në vende të ndryshme të botës, duke përfshirë SHBA, Holandë, Austri, Turqi, Itali, Britani e Madhe etj. Kjo ndikon pozitivisht në përgatitjen e studentëve, pasi i ofron atyre mundësinë e njohjes dhe pasurimit të aftësive, falë këndvështrimeve të ndryshme.
6. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, i cili ofron dhe Programin e Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*” është pjesë e Kolegjit Universitar Bedër, institucion arsimor jofitimprurës. Falë këtij statusi, Kolegji Universitar “Bedër” renditet përkrah institucioneve të arsimit të lartë, në të cilat çdo mundësi kthehet në investim për studentin.
7. Falë memorandumeve të bashkëpunimit të Kolegjit Universitar “Bedër” me një sërë institucioneve arsimore publike dhe jopublike si dhe kompanive të shumta, Programin e Studimit “Master profesional” në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile: *Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët*” mundëson praktika mësimore të frytshme për studentët e vet. Krahas tyre e në sajë të këtyre bashkëpunimeve, studentëve iu ofrohen workshop-e dhe leksione të hapura nga përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile e bizneseve, çfarë i bën ata edhe me të aftë për tregun e punës.²¹⁸
8. Biblioteka tradicionale dhe online me literaturë të pasur në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera të huaja mundëson dhe lehtëson punën kërkimore për stafin dhe studentët e KU

²¹⁸ Evidenca nr. 83: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Evropën të Ndryshme



- “Bedër”. Gjithashtu, akses i lehtë dhe pa pagesë në JSTOR bën të mundur lëvrimin e materialeve të ndryshme për të gjithë studentët dhe stafin akademik, duke shtuar mundësinë e thellimit të njohurive dhe të cilësisë së kërkimit shkencor.
9. Administrimi online i të dhënave në KU “Bedër” përmes sistemit BIS rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, transparencën si dhe siguron përfitim të shpejtë të të dhënave, çfarë i vjen në ndihmë dhe stafit akademik e atij administrativ.
 10. Kolegji Universitar “Bedër” është i pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor bashkëkohor. Pajisja e ambienteve mësimore me kushte kondicionimi, tabela interaktive (Smart Boards), projektorë, karrige ortopedike, laboratorë modern me parametra shumë të lartë etj., mundësojnë një proces mësimor cilësor.
 11. Bursat dhe tarifat e studimeve të aplikuara në Kolegjin Universitar “Bedër” janë konkurruese dhe motivuese për studentët, çfarë reflektohet në cilësinë e studentëve të pranuar. Për më tepër, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe institucionale, ata synojnë gjithëpërfshirje dhe ndërkombëtarizim.²¹⁹
 12. Dekanati i studentëve luan rol të rëndësishëm në jetën studentore në Kolegjin Universitar “Bedër”. Kjo njësi ndihmon në ndjekjen e aktiviteteve të organizuara nga klubet studentore si dhe në praktikat profesionale të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
 13. Organizimi i vazhdueshëm i konferencave ndërkombëtare, seminareve dhe projekteve të ngjashme shkencore, leksioneve të hapura, trajnimeve të ndryshme në të cilat studentët angazhohen në mënyrë aktive është një qasje e vlerësueshme e KU “Bedër” që gjithashtu mbështet rritjen profesionale të stafit dhe studentëve në këtë institucion.
